Majlinda Hala Valbona Duraj - Muho

LIBËR PËR MËSUESIN
ART MUZIKOR
10

Majlinda Hala Valbona Duraj - Muho

LIBËR PËR MËSUESIN
ART MUZIKOR
10

BOTIME
pegi

Dr. Majlinda Hala

Valbona Duraj - Muho

Libër për mësuesin
ART MUZIKOR 10

Për klasën e 10-të të arsimit të mesëm të përgjithshëm

BOTIME

pegi

Prishtinë. 2019

BOTIME

Drejtoi botimin: Valmira MUSHI
Recensentë të MASHT-së: Merita JUNIKU, Genita HOXHA,
Jehona RRUSTEMI, Trendelina KRASNIQI
Korrektor letrar: Arlon LIKO
Paraqitja grafike: Elvis BEJTJA
Kopertina: Elidor KRUJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-786-09-6

© Botime Pegi sh.p.k., dega në Kosovë, korrik 2019
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht
të zotëruara nga Botime Pegi sh.p.k. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim,
përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht
ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Sektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtje

Hyrje 5

Plani vjetor 7

Modele të planifikimeve të orëve mësimore 22

Hyrje

Muzika qëndron mes të gjitha formave të tjera inteligjente të njeriut (artit në përgjithësi, shkencave shoqërore e historike dhe shkencave artistike), si një përbërës i barabartë me to i progresit intelektual dhe i humanitetit.

Vazhdimi i rrugëtimit të njohjes me muzikën është një vlerë e madhe për të mundësuar **edukimin dhe formimin kulturor, zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e aftësive të tyre për të dëgjuar në mënyrë të pavarur e sistematike vepra të ndryshme muzikore si dhe për të menduar dhe gjykuar në mënyrë kritike** rreth tyre.

Muzika nuk mund të kuptohet dhe realizohet duke marrë vetëm disa njohuri, por duke vazhduar njohjen më të plotë të saj përmes gjuhës muzikore dhe komunikimit nëpërmjet saj, të njohjes me veprat muzikore, konkretizimin e njohurive muzikore përmes realizimit të teknikave dhe proceseve, si dhe njohjes me zhvillimin kulturor dhe historik të muzikës, njohuri që bëjnë të vetëdijshëm nxënësin për rolin e muzikës në jetën e përditshme dhe vlerësimin e saj nëpërmjet një gjuhe të saktë muzikore.

Muzika edukon nxënësin/en nga pikëpamja estetike dhe muzikore, duke e orientuar atë në mënyrë të saktë drejt kuptimit të vlerave estetike dhe muzikore nga abstraktja te konkretja, në njohjen me gjinitë dhe llojet e ndryshme të muzikës, si dhe me zhvillimin historik të muzikës në periudha, kontekste dhe kultura të ndryshme.

Pse shërben ky libër?

Ky libër do të udhëheqë mësuesit në zhvillimin e Artit muzikor në arsimin e mesëm të lartë, në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale, duke kuptuar më së miri qasjen me bazë kompetencat edhe në kurrikulën e muzikës.

Çfarë synon ky libër?

Qëllimi i këtij libri është orientimi i mësuesit/es që japin muzikë në klasën e 10-të, për të përmbushur synimet e kësaj kurrikule dhe zbatimin me sukses i saj kalon nëpër tri elemente mjaft të rëndësishme:

a) planifikimin e të nxënit sipas **formateve të reja**;
b) zbatimin e metodologjinë e mësimdhënies, bazuar në **teknikave të mësimdhënies**;
c) realizimin e **vlerësimit** për të nxënë dhe i të nxënit.

Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me programin e klasës së dhjetë, përkatësisht shkalla e pestë e lëndës Art muzikor, miratuar nga MASHT-i, në 2018.
Ky libër merr përsipër:

- **të sqarojë** çdo mësues/e të artit muzikor për të gjitha çështjet e planifikimit, metodologjisë dhe vlerësimit, që duhet të zbatojë në lëndën e tij/saj.
- **të udhëheqë** çdo mësues/e me formatet e planifikimit e kërkuara dhe mënyrën se si ato duhet të përdoren në lëndën e muzikës, duke i udhëzuar **ata** mbi: planifikimin vjetor, periudhave ditore, situatat e të nxënit, format e vlerësimit etj., me të cilat duhet të punojë gjatë një viti shkollor.

Ky libër në parim ofron modele ose i sugjeron ato por nuk i dikton ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të realitetit dhe nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim.
Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

AUTORET

II. Programi mësimor, kompetencat dhe kuptimi i tyre

Ky libër përshkruan në mënyrë të detajuar programin mësimor të muzikës, klasa e 10-të dhe udhëheq mësuesin/en për ndërtimin e **kompetencave të lëndës** së **muzikës** si dhe të **kompetencave kyçe**, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën.
Kjo lëndë vazhdon të zhvillohet në arsimin e mesëm të lartë (AML), pikërisht në shkallën e pestë ose të gjashtë.
Kompetencat kyçe dhe muzika
Fjala kompetencë ka filluar të zbatohet tashmë në mjediset mësimore. Kompetencat shprehen nëpërmjet rezultateve të të nxënit, duke dhënë qartë rolin që ato kanë në përdorimin dhe në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave kontekstuale në të cilën zhvillohet njohuria muzikore.
Domosdoshmëria e zotërimit të kompetencave i aftëson nxënësit të bëhen të aftë dhe t'i përdorin ato përgjatë gjithë jetës.

Kompetencat kyçe janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

Çdo mësues/e duhet të dijë pse shërbejnë **6 kompetencat kyçe**, duke ditur sesi t'i zhvillojë dhe ndërtojë ato në kontekstin e lëndës së vet me nxënësit sipas formateve të përcaktuara. Këto kompetenca ndërtohet dhe arrihen përgjatë shkallës duke ndërtuar përmes një nxënës që zotëron aftësinë e:

- Komunikues efektiv
- Mendimi kreativ
- Individi i suksesshëm
- Kontribuues produktiv
- Individ i shëndoshë
- Qytetar i përgjegjshëm

Mësuesi/ja duhet të kujdeset që përveç njohurive muzikore, të zhvillojë domosdoshmërisht me nxënësit e tij/saj edhe kompetencat kyçe.

III. Stilet e të nxënit, pjesë e planifikimit dhe e zhvillimit të artit muzikor, klasa X

Planifikimi i punës mësimore dhe procesi i mësimdhënies është një fazë e cila kërkon t'i japë nxënësit njohuritë e duhura, të nxisë nevojat e tyre, interesat dhe mënyrat e tyre të të mësuarit. Procesi mësimor do të ketë rezultate pikërisht nëse nxënësit janë të nxitur për të nxënë dhe ku secili nxënës mëson sipas një mënyre të caktuar apo të njohur në literaturën pedagogjike si stile të të nxënit. Disa nxënës mësojnë përmes perceptimit, të tjerë mësojnë duke analizuar apo reflektuar, disa përmes të parit dhe të dëgjuarit, disa mësojnë vetëm, të tjerë mësojnë në grupe, disa mësojnë në tërësi përmbajtjen mësimore, ndërsa të tjerë e ndajnë atë në pjesë më të vogla logjike.

Krahas këtyre përcaktimeve të të nxënit, janë mësuesit, të cilët gjatë përdorimit të strategjive dhe metodave në procesin mësimor, nxjerrin në pah artin dhe mjeshtërinë e tyre, por edhe vënë në zbatim përmes stileve të të nxënit këto metoda. Mësuesit në mësimin e muzikës duhet të përdorin më shumë demonstrimin, bisedën, lojën me role, reflektimin, diskutimet. Për të arritur sukses në procesin mësimor duhet patjetër që mësuesi/ja t'i zbatojë stilet e të nxënit, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit, pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënit dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura. Stilet e të nxënit, nëpërmjet metodave dhe teknikave të mësimdhënies përmbush detyra të rëndësishme të mësimdhënies dhe:

III.1. Stili i të nxënit pamor, është kur nxënësi e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së të parit. Në këtë rast, mësimi konkretizohet, duke përdorur mjete mësimore si: fotografi, grafikë, piktura, ngjyra, ilustrime, instrumente muzikore, dvd (ku ndërthuret edhe stilin dëgjimor). Të nxënit përmes të parit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi/ja ku kërkohet përqendrimi i nxënësve në:

- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të memorizuar apo për të kujtuar një ndodhi, një ngjarje, një situatë të caktuar në kontekstin e temës mësimore.
- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të nxitur diskutimin apo për të verifikuar njohuritë e marra më parë.

III.2. Stili i të nxënit dëgjimor, është kur nxënësi e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së dëgjimit. Këta nxënës përvetësojnë më mirë dhe më lehtë njohuritë nëpërmjet dëgjimeve të fragmenteve muzikore, improvizime përmes lëvizjeve trupore, krijimeve nëpërmjet përjetimit nga dëgjimi i muzikës ku bëhen krijime të ndryshme dhe diskutohet për to. Të nxënit përmes dëgjimit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi/ja ku kërkohet përfshirja e nxënësve në:

- dëgjimin e muzikës dhe edukimin e përqendrimit për të dëgjuar muzikë;
- dëgjimin e muzikës dhe mësimin e këngëve për fëmijë apo këngëve lojë dhe diskutimin në lidhje me tekstin dhe melodinë e këngës;
- dëgjimin e muzikës dhe improvizimin përmes lëvizjeve trupore apo vizatimit në kontekstin e temës mësimore;
- dëgjimin e muzikës dhe nxitjen e bisedave apo diskutime në lidhje me fragmentin muzikor që dëgjon;
- dëgjimin e muzikës dhe prezantimin e krijimeve të ndryshme të krijuara nën përjetimin e muzikës.

III.3. Stili i të nxënit kinestetik, është kur nxënësi/ja përvetëson përmbajtjet mësimore në mënyrë aktive, duke vepruar, luajtur, shkruar, vizatuar etj. Këta nxënës janë më të suksesshëm nëse:

> e prekin dhe e ndjejnë përmbajtjen mësimore;
> i përdorin pjesët trupore dhe ndjenjat;
> përdorin gjuhën e ndjenjave.

Përmes stileve të të nxënit nxënësit zhvillojnë prirje dhe shkathtësi të ndryshme p.sh.: bashkëveprimi në lojëra të ndryshme muzikore, apo aktivitete në grup, performime muzikore dhe kërcimore në shfaqjet skenike, kërcim apo teatër, biseda në lidhje me temën e mësimit etj.

Të tria këto stile harmonizohen dhe ndihmojnë çdo mësues të planifikojë veprimtari të larmishme mësimore muzikore, duke i përdorur ato përmes teknikave dhe metodave të mësimdhënies.

Disa veprimtari muzikore që kanë të bëjnë me procesin e mësimit të muzikës ku ndihmojnë dhe stilet e të nxënit janë:

1) Mësimi i këngëve bën pjesë në stilin e <u>të nxënit pamor, dëgjimor por edhe kinestetik,</u> sepse këngët duhet:
- të mësohen;
- të këndohen duke respektuar të gjitha kërkesat e këndimit dhe repertori i sugjeruar për t'u mësuar;
- të shoqërohet edhe me instrumente muzikore popullore, por edhe Orf;
- të shoqërohet me lëvizje trupore.

2) Në fushën e lojës me instrumente muzikore, mësuesi/ja bashkëpunon dhe synon vënien në përdorim të funksionit të muskujve të duarve gjatë luajtjes në instrument muzikor duke i angazhuar nxënësit në përdorimin e instrumenteve muzikore popullore shqiptare të ngjashme edhe me instrumentet ORF për shoqërimin e këngëve që këndojnë.

3) Dëgjimi muzikor bën pjesë në stilin e <u>të nxënit pamor, dëgjimor por edhe kinestetik,</u> sepse edukon përqendrimin dhe vëmendjen ndaj dëgjimit të muzikës, dhe memorizimin e njohurive muzikore në përjetimin e muzikës përmes veprave muzikore shqiptare dhe ato botërore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies për të përmbushur stilet e të nxënit në muzikë janë të shumta, dhe i japin mundësinë çdo nxënësi të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor dhe artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të muzikës do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë, kuptojnë, krijojnë dhe performojnë muzikën nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies për të përmbushur stilet e të nxënit në muzikë janë të shumta, dhe i japin mundësinë çdo nxënësi/je të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor dhe artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të muzikës do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë, kuptojnë, krijojnë dhe performojnë muzikën nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike.

Disa teknika shumë efikase në orën e muzikës janë Brainstorming, Klaster, Harta e të pyeturit, Diagrami i Venit, DDM, Harta e koncepteve, Kubimi, INSERT etj.

IV. Teknika të mësimdhënies



Në stilin e të nxënit pamor dhe dëgjimor veçojmë edhe teknikën e kllasterit. **Kllasteri**, ose grupimi i mendimeve që, ndonjëherë, në literaturë emërtohet
"harta e mendimeve", është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, duke sjellë nga kujtesa njohuritë muzikore që ata kanë dhe plotësuar ato më tej gjatë fazave të tjera të orës mësimore.



Rrjeti i diskutimit është një teknikë e mësimdhënies, gjatë së
cilës bëhet organizimi grafik i informacionit. Kjo teknikë i bën nxënësit të jenë të vëmendshëm ndaj dëgjimit të veprave muzikore, për të kuptuar përmbajtjen muzikore të veprave dhe krahasuar ato. Përdoret në fazën e realizimit të kuptimit dhe të reflektimit. Sipas kësaj teknike, klasa ndahet në dy grupe ("Pro" dhe "Kundër"). Grupet mund të jenë edhe mbi 20 vetë. Diskutimi midis grupeve vazhdon 15-25', sipas temës dhe mund të realizohet me nxënës të çdo moshe.

Brainstorming, është një veprimtari që bën pjesë në **stilin pamor** por edhe dëgjimor, duke iu përshtatur lëndës së muzikës, sepse nëpërmjet vendosjes së një fjale kryesore apo fragmenti muzikor për dëgjim Cd, shërben si fillimi i një diskutimi në mësim për një problem të caktuar, i cili më pas vazhdon me metoda e teknika të tjera.
Qëllimi i përdorimit të Brainstorming-ut është të vërë në dukje sa më shumë ide, zgjidhje ose komente për një problem të dhënë. Brainstorming-u përdoret për të shprehur ide të reja me të gjithë klasën ose me një grup nxënësish dhe karakterizohet nga një lojë me përmasa të gjera dhe nga një intensitet i të shprehurit të larmishëm për gjëra të njohura. P.sh. shkruhet në dërrasë të zezë fjala "Muzika popullore shqiptare", ose vendosjen e një muzike popullore mjaft të njohur për dëgjim ku nxënësve u kërkohet të flasin rreth asaj që dinë mbi muzikën popullore shqiptare, duke sjellë informacion mbi muzikën e krahinës së vet.



Kjo teknikë kërkon të mbahet parasysh:

- Të mos kritikohet asnjë prej zgjidhjeve e ideve.
- Të nxiten nxënësit të shprehin ide.
- Diskutimi të zhvillohet për gjëra të njohura.
- Të aktivizohen edhe nxënës të ndrojtur.
- Të shërbejë si nxehje e trurit.

Kubimi është një teknikë që mund të bëjë pjesë në **stilin dëgjimor** sepse përmes vendosjes së një vepre dëgjimore shqiptare, ndihmon shqyrtimin e veprës nga këndvështrime të ndryshme, për shkak të përjetimit

emocional që është i ndryshëm te gjithsecili. Ai përfshin përdorimin e një kubi me lëvizje të shpejta për të menduarin, të shkruarin në secilën faqe të kubit. Mund të ndërtohet duke mbuluar një kuti të vogël me letër. Në secilën faqe të kubit shkruhen 6 kërkesa të shkurtra: Përshkruaje, krahasoje, shoqëroje, analizoje, argumentoje (pro ose kundër) p.sh.:

- vepër muzikore, këngën, muzikën popullore, dy kompozitorë, ku nxënësit udhëzohen të mendojnë për t'u dhënë përgjigje-pyetjeve të mësuesit/es dhe ta përshkruajnë atë: (forma muzikore, karakteri i veprës, subjekti që trajton vepra etj.).



Tabela e koncepteve është një teknikë që bën pjesë në **stilin dëgjimor**, një teknikë racionale për të organizuar informacionin muzikor përmes dëgjimit dhe krahasimit të disa veprave muzikore. Përdoret veçanërisht kur jepen njëkohësisht më shumë se një koncept a dukuri. Ndihmon së tepërmi të kuptuarit, përmes strukturimit të materialit, pas leximit dhe në realizmin e skemave të qarta, që sigurojnë qëndrueshmërinë e dijeve. Kjo teknikë përdoret me sukses në fazën e realizimit të kuptimit dhe reflektimit. Tabela e koncepteve hartohet duke renditur konceptet apo njohuritë muzikore që duhet të krahasohen. Në kolona renditen tiparet apo karakteristikat mbi bazën e të cilave bëhet ky krahasimi i veprave muzikore.

TIPARE DALLUESE	TË PËRBASHKËTAT	TIPARE DALLUESE
_____ _____ _____	_____ _____ _____	_____ _____ _____

Diagrami i Venit është teknikë që bën pjesë në **stilin dëgjimor** më anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve muzikore, formave muzikore, ngjarjeve muzikore, kompozitorëve të ndryshëm, 2 periudhave muzikore etj. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit, pothuajse në çdo orë mësimi. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimit, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to.

Harta e të pyeturit është teknikë që i përket stilit pamor dhe dëgjimor:
është një skicë që shfaq idetë e rëndësishme të mësimit, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit e cila shoqërohet me fragmente të ndryshme muzikore.

Përparësitë:

- Hap rrugën për diskutim.
- Ndihmon nxënësit për të zhvilluar aftësi më të mëdha të të menduarit.
- Tërheq nxënësit në punët e pavarura.
- Rrit rolin e nxënësve në mësim.
- Nxit të menduarit logjik.
- Nxit dhe tërheq nxënësit pasivë.

Si të krijojmë një hartë të pyeturi? Për të përpiluar një hartë të pyeturi, mund të ndiqet kjo rregullsi:

- Shkruhet tema e mësimit që do të shpjegohet në qendër të tabelës.
- Pas kësaj vizatohet harta e të pyeturit, në të cilën pas pyetjeve kyç, gjenden të lidhura edhe pyetje të tjera që zgjerojnë hartën.

Të mësuarit me projekte (Projekti)

- Projekti kurrikular është strategji e të nxënit dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj.
- Projekti kurrikular në lëndën e muzikës është **rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënit.**
- Projekti kurrikular **nuk** duhet të përmbajë njohuri të reja.
- Zbatimi i një projekti në lëndën e muzikës kërkon më shumë se një orë mësimore.
- Projekti kurrikular **mund** të jetë i shtrirë **përgjatë gjithë vitit shkollor**, pra në të tria periudhat, por mund të jetë i shtrirë dhe **vetëm brenda një periudhe**. Sido që të jetë shtrirja e projektit, ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Mësuesi/ja që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi/ja vlerëson nxënësit përgjatë zhvillimit të tij.

V. Organizimi i procesit të mësimit

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënit të muzikës është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor/artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të muzikës, do të thotë që nxënësit/et të vendosen në situata konkrete krijuese, ku ata përjetojnë dhe provojnë vetë gjatë proceseve muzikore. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet motivimit dhe përkundrejt zhvillimit të kompetencave të caktuara si dhe temave përkatëse mësimore. Mësimdhënia e muzikës, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari krijuese, shprehëse, emocionale. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore muzikore është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt saj në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit intelektual/krijues dhe artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia e muzikës, synon gjithëpërfshirjen dhe bazohet:

- **në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca;**
- **mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e nxënien e integruar**.

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës sesi ata/ato nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e muzikës mban parasysh:

- **ndërtimin** e kompetencave kryesore të të nxënit në muzikë;
- **lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale** të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- **formimin dhe forcimin** aftësive dhe shprehive muzikore;
- **zbatimin** e veprimtarive krijuese/interpretuese/vlerësuese muzikore, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet muzikore me situata të jetës reale;
- **përdorimin** e mjeteve muzikore konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë CD, DVD, kompjuter, magnetofon;
- **nevojën e individit** për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- **zhvillimin e qëndrimit pozitiv** ndaj lëndës së muzikës dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
- **nxitjen e bashkëveprimit** mësues-nxënës që në procesin mësimor, mësuesi/ja dhe nxënësi të jenë plotësues të njëri-tjetrit.

Një planifikim i mirë krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Çdo **model i planifikimit ditor** është sugjerues, sepse kërkon të nxisë dhe orientojë mësuesit rreth zhvillimit të orës mësimore.
Niveli i nxënësve, burimet materiale, përvoja e vetë mësuesit/es, mjetet në dispozicion për realizimin orës mësimore, dhe për këtë arsye vendosja e rezultateve të të nxënit për zhvillimin e kompetencave kyçe **nuk** mund të jenë për të gjithë njësoj. Kështu që çdo mësues/e zgjedh të zhvillojë sipas këtij modeli të sugjeruar, por mund të zhvillojë këtë situatë apo të zhvillojë temën mësimore në një situatë tipike për klasën e tij. Ato kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve përmes njohurive që ata kanë. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, krijime ose simulime të njohurive, interpretimeve/performimeve, gjykimeve dhe qëndrimeve artistike. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi/ja duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në muzikë.
Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësit të punojnë me situata dhe veprimtari reale që ata i njohin, ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si:

- "Pse shërben muzika në jetën e përditshme?"
- "A ndihmon muzika në përmirësimin e emocioneve tona?"
- "Kush është kënga/rryma ime e preferuar?"
- "Cilat janë pjesët muzikore të preferuara dhe kompozitori im i dashur?"
- "Çfarë di për jetën dhe veprën e tij" etj.

Në këtë mënyrë, ai inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e veta dhe të zhvillojë situata të reja në kontekste të caktuara.

Detyrat përmbledhëse/shfaqjet muzikore, ese-të, projektet individuale dhe në grup, kërkimet mbi çështje të ndryshme, gjykimet dhe qëndrimet personale janë një tjetër mënyrë që i krijojnë nxënësit mundësinë të zbatojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron, si dhe nga ana tjetër arrin të krijojë lidhje integruese me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj.
Prezantimet e punimeve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave muzikore/artistike, por edhe të gjitha të kompetencave kyçe.

VI. Materiale dhe burime mësimore

Gjatë mësimit të muzikës për realizimin e kompetencave, mësuesi/ja përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi/ja i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai/ajo përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedisin e përshtatshëm për aktivitete. Teknologjia ka një ndikim të madh në muzikë duke ndihmuar nxënësit të eksplorojnë këngë me tematikë të ndryshme, për të rinj, arie, muzikal, vepra muzikore të ndryshme, duke zhvilluar aftësitë e tyre në njohjen më të plotë të muzikës. Tekstet dhe materialet sigurojnë përmes përdorimit të tyre një qasje të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Me anë të medieve, detyrave dhe projekteve të ndryshme nxënësve u krijohet mundësia të demonstrojnë apo të prezantojnë punët dhe krijimet e tyre.

Muzika studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, materialeve, teknikave e procedurave specifike muzikore, p.sh.: për dëgjim muzikor, shikim të shfaqjeve për ndjekjen e pjesëve muzikore, të këngëve përdoren magnetofoni, TV-ja, CD-ja dhe DVD-ja.

Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, internet etj.
Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- Mjetet audiovizive si: Tv, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- Mjetet dëgjimore: radio, magnetofon etj.
- Mjetet verbale, tekstet si: tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe për të demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për muzikën. Ky plan është i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit/et në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në krijime të ndryshme.
- Mjedisi mësimor (klasa, kabinetet e muzikës etj.).

VII. Organizimi dhe kuptimi i tekstit të nxënësit, sipas programit mësimor

Lënda Art muzikor është e bazuar në qasjen me kompetenca dhe është i gjithë procesi i të nxënit që zhvillohet në fushën e arteve në përgjithësi, në të gjitha shkallët. Në të gjitha shkallët e kurrikulës, ato zhvillohen dhe plotësohen më tej me **rezultate të të nxënit** brenda secilës lëndë mësimore të fushës së arteve.

Përvetësimi i njohurive muzikore nënkupton **zotërimin e kompetencave muzikore**. Në këto kushte, **zotërimi i kompetencave muzikore** do të thotë aftësia për të kuptuar, gjykuar përdorur muzikën në një shumëllojshmëri situatash dhe kontekstesh jo vetëm brenda kontekstit të programit mësimor dhe kërkesave të tij, por edhe në situata në të cilën muzika luan ose mund të luajë një rol të rëndësishëm.
Me kurrikulën e re, muzika është strukturuar me katër (4) tërësi përmbajtjesore të koncepteve dhe temat mësimore për secilën prej tyre, të cilat listohen si më poshtë:

KOCEPTET[1]	TEMAT MËSIMORE
KRIJIMTARI DHE PERFORMANCË ARTISTIKE	Këngë Interpretim me instrument
GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK	Gjuha muzikore dhe shkrimi muzikor Format muzikore
MUZIKA DHE SHOQËRIA	Zhvillimi historik i muzikës dhe stili muzikor Zhanret muzikore Krijues dhe performues Institucionet muzikore
ÇMUARJA DHE VLERËSIMI ESTETIK – ARTISTIK	Ngjarje muzikore Vepra muzikore

Në çdo njësi mësimore merren informacione të reja për këngët, veprat dhe kompozitorët nëpërmjet zhvillimit të veprimtarive muzikore: këndim, dëgjim, interpretim dhe vlerësim. Në fund, zotërohen njohuri dhe aftësi të mjaftueshme muzikore e kulturore, të cilat provohen në një testim, koncert apo paraqitje të një teme të caktuar, duke punuar vetëm ose në grup.

VIII. Kuptimi dhe interpretimi i simboleve që përndjekin tekstin e nxënësit

Simboli në tekstin e nxënësit	Kuptimi i simbolit si e gjejmë në tekst
Vëzhgoni dhe diskutoni	Vëzhgim dhe zbulim nga e panjohura drejt të njohurës.
DËGJONI	Dëgjim muzikor të fragmenteve muzikore për ilustrim.
PORTOFOLI I PUNËS	Vetëvlerësim dhe verifikim i njohurive muzikore të marra.

1 Secila tematikë e lëndës së muzikës duhet të realizojë të katërta (4) kompetencat lëndore.

PLANI VJETOR

Fusha e kurrikulës: Arte

Klasa: X (dhjetë)

Lëndët e fushës	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallë
Lënda: Art muzikor	**PERIUDHA (I)**		**PERIUDHA (II)**	**PERIUDHA (III)**	Komunikues efektiv I. 3, 7, 8, 9 Mendimi kreativ II. 1, 3, 5, 7 Nxënës i suksesshëm III. 4, 5 Kontribuues produktiv IV. 1,3 Individ i shëndoshë V. 2 Qytetar i përgjegjshëm VI. 1, 4
	Shtator-Tetor 9 orë	**Nëntor-Dhjetor 8 orë**	**Janar-Shkurt-Mars 9 orë**	**Prill-Maj-Qershor 8 orë**	
	Këngë (2 orë)	Këngë (2 orë)	Këngë (3 orë)	Këngë (1 orë)	
	Format muzikore (2 orë)				
	Zhvillimi historik dhe stili muzikor (4 orë)	Zhvillimi historik dhe stili muzikor (4 orë)	Zhvillimi historik dhe stili muzikor (3 orë)	Zhvillimi historik dhe stili muzikor (3 orë)	
	Krijues dhe vepra (1 orë)	Krijues dhe vepra (2 orë)	Krijues dhe vepra (2 orë)	Krijues dhe vepra (1 orë)	
				Zhanret muzikore (1 orë)	
			Ngjarje muzikore (1 orë)	Ngjarje muzikore (1 orë)	
				Vepra muzikore (1 orë)	
	Planifikime (2 orë)				

PERIUDHA (I)

MUAJT: *SHTATOR-TETOR/NËNTOR-DHJETOR*

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

LËNDA MËSIMORE: ART MUZIKOR

KLASA: X

Tema mësimore: Këngë, interpretime me instrumente

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit/
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:
1.1. Performojnë pjesë (këngë, valle, pjesë teatrale) të formave, gjinive dhe zhanreve të ndryshme muzikore, duke aplikuar teknika më të avancuara interpretuese dhe kombinuar teknikat interpretuese në disiplinat e ndryshme artistike.
1.3**.** Prezantojnë aftësitë e tyre krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.

2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar.
2.2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.
3.1. Identifikojnë dhe elaborojnë me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
3.2. Përcaktojnë ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë.
3.3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
3. 4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.

Tema mësimore: Format muzikore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:
Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive..
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit**.**
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit**.**

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

1.2. Performojnë pjesë (këngë, valle, pjesë teatrale) të formave, gjinive dhe zhanreve të ndryshme muzikore, duke aplikuar teknika më të avancuara interpretuese dhe kombinuar teknikat interpretuese në disiplinat e ndryshme artistike.

1.3. Prezantojnë aftësitë e tyre krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.
2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar.
2.2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.
3.1. Identifikojnë dhe elaborojnë me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve.
artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
3.2. Përcaktojnë ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë.
3.3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
3. 4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.

Tema mësimore: Zhvillimi historik dhe stilet muzikore, krijues dhe përfaqësues

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:
Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit**.**
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2. Dëshmim i vetëbesimit.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar.

2. 2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.
3.1. Identifikojnë dhe elaborojnë me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
3.2. Përcaktojnë ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë.
3.3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
3. 4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.

Tema mësimore: Institucione, ngjare muzikore dhe vepra

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit**.**
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

4.1. Demonstrojnë të kuptuarit se si artet komunikojnë ide përmes vlerave personale dhe shoqërore të inspiruara nga imagjinata individuale dhe konteksti historik, kulturor dhe social i krijuesit.
4.2. Zhvillojnë mendimin e tyre kritik dhe analitik për të vlerësuar veprat e ndryshme të artit në aspektin estetik.
4.3. Zhvillojnë aftësinë e shijimit dhe përjetimit të veprave artistike duke kultivuar dhe rafinuar shijen e tyre estetike në art.
4. 4.Krijojnë kulturën debatuese për diskutimin dhe trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit.

PERIUDHA (I) MUAJT: *SHTATOR-TETOR/NËNTOR-DHJETOR*							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha e mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare**	**Burimet**
Këngë **Format muzikore**	Nxënësit këndojnë individualisht dhe në grup këngë në tema dhe zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë, etj.) me tematikë që i përshtatet interesit dhe moshës së nxënësve të klasës X (dashurisë, këngë patriotike, këngë popullore, këngë të lehta argëtuese për çaste festive etj.). Nxënësit këndojnë motive e tema të njohura të veprave muzikore vokale dhe instrumentale nga periudha të ndryshme stilistike. Nxënësit dallojnë dhe emërojnë saktë elementet e muzikës (ritmin, metrin, melodinë, intervalet, harmoninë, tempin, dinamikën) përmes këngëve dhe dëgjimit muzikor.	Zëri dhe rregullat e këndimit Rregullat e këndimit Himni Kombëtar dhe i Kosovës Struktura muzikore Format muzikore Forma 1-2-3 pjesëshe Muzika në Mesopotami, Egjipt, Indi dhe Kinë Muzika në Greqinë dhe Romën e lashtë Muzika në mesjetën e hershme Muzika në mesjetën e lulëzuar (shekulli XI–XV) Kompozitorë të huaj	17	Bisedë Diskutim *Brainstorming* Diagrami e Venit Harta e të pyeturit Kllaster Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli e nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë **Çështjet ndërkurrikulare** Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Teksti shkollor Softuerë arsimorë Cd Dvd

PERIUDHA (I) MUAJT: *SHTATOR-TETOR/NËNTOR-DHJETOR*							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha e mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare**	**Burimet**
Zhvillimi historik dhe stilet muzikore **Krijues dhe performues**	Nxënësit dallojnë karakteristikat e formave muzikore si sonata, simfonia, koncerti, suita në periudha të ndryshme historike e në zhanre e stile të ndryshme muzikore. Nxënësit dallojnë krijuesit, performuesit dhe veprat artistike nga krijimtaria artistike, popullore kombëtare dhe botërore të periudhave të ndryshme (se paku nga 3 për çdo periudhe stilistike-muzikore).					Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë Globalizimi dhe ndërvarësia Edukimi për media	

PERIUDHA (II)

MUAJT: *JANAR, SHKURT, MARS*

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

LËNDA MËSIMORE: ART MUZIKOR

KLASA: X

Tema mësimore: Këngë, interpretime me instrumente

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit**.**
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit**.**

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

1.2. Performojnë pjesë (këngë, valle, pjesë teatrale) të formave, gjinive dhe zhanreve të ndryshme muzikore, duke aplikuar teknika më të avancuara interpretuese dhe kombinuar teknikat interpretuese në disiplinat e ndryshme artistike.

1.3. Prezantojnë aftësitë e tyre krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.
2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar.
2. 2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.
3.1. Identifikojnë dhe elaborojnë me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
3.2. Përcaktojnë ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë.
3.3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
3. 4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.

Tema mësimore: Format muzikore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

1.2 Performojnë pjesë (këngë, valle, pjesë teatrale) të formave, gjinive dhe zhanreve të ndryshme muzikore, duke aplikuar teknika më të avancuara interpretuese dhe kombinuar teknikat interpretuese në disiplinat e ndryshme artistike.
1.3. Prezantojnë aftësitë e tyre krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.
2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar.
2.2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.
3.1. Identifikojnë dhe elaborojnë me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
3.2. Përcaktojnë ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë.
3.3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
3.4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.

Tema mësimore: Zhvillimi historik dhe stilet muzikore, krijues dhe përfaqësues
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
Individ i shëndoshë:

V.2. Dëshmim i vetëbesimit

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar.
2.2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.
3.1. Identifikojnë dhe elaborojnë me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
3.2. Përcaktojnë ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë.
3.3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
3.4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.

Tema mësimore: Institucione, ngjare muzikore dhe vepra
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:
II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:
III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:
V.2. Dëshmim i vetëbesimit
Qytetar i përgjegjshëm:
VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:
4.1. Demonstrojnë të kuptuarit se si artet komunikojnë ide përmes vlerave personale dhe shoqërore të inspiruara nga imagjinata individuale dhe konteksti historik, kulturor dhe social i krijuesit.
4.2. Zhvillojnë mendimin e tyre kritik dhe analitik për të vlerësuar veprat e ndryshme të artit në aspektin estetik.
4.3. Zhvillojnë aftësinë e shijimit dhe përjetimit të veprave artistike duke kultivuar dhe rafinuar shijen e tyre estetike në art.
4.4. Krijojnë kulturën debatuese për diskutimin dhe trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit.

PERIUDHA (II) MUAJT: *JANAR/SHKURT/MARS*							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare**	**Burimet**
Këngë **Interpretime muzikore**	Nxënësit këndojnë individualisht dhe në grup këngë në tema dhe zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë etj.) me tematikë që i përshtatet interesit dhe moshës së nxënësve të klasës X (dashurisë, këngë patriotike, këngë popullore, këngë të lehta argëtuese për çaste festive etj.) Nxënësit këndojnë motive e tema të njohura të veprave muzikore vokale dhe instrumentale nga periudha të ndryshme stilistike. Nxënësit interpretojnë shoqërime këngësh dhe pjesë të vogla instrumentale sipas imitimit ose me tekst notal në zhanre të ndryshme që ata i preferojnë.	Himni i Evropës "Oda e gëzimit;" Kënga: "Lule Borë", Simon Gjoni Kompozitorë të huaj dhe shqiptarë Institucionet muzikore në Kosovë, Shqipëri dhe botë Muzika dhe kultura e popujve, lufta, puna, shëndeti	9	Bisedë Diskutim *Brainstorming* Diagrami e Venit Harta e të pyeturit Kllaster Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli e nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti' Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë **Çështjet ndërkurrikulare** Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë Globalizimi dhe ndërvarësia	Teksti shkollor Softuerë arsimorë Cd Dvd

PERIUDHA (II) MUAJT: *JANAR/SHKURT/MARS*							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare**	**Burimet**
Zhvillimi historik dhe stilet muzikore **Krijues dhe performues** **Institucionet muzikore**	Formojnë bendet muzikore, grupet e vallëzimit etj., sipas interesimit të tyre. Nxënësit dallojnë dhe njohin karakteristikat e zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, jaz, rok) përmes dëgjimit muzikor. Nxënësit dallojnë karakteristikat stilistike dhe fitojnë njohuri për artin muzikor në epoka të ndryshme, njohin veprat dhe përfaqësuesit më të rëndësishëm të atyre epokave. Nxënësit dallojnë instrumentet muzikore dhe formacionet karakteristike të periudhave të ndryshme historike. Nxënësit dallojnë krijuesit, performuesit dhe veprat					Edukimi për media	

PERIUDHA (II) MUAJT: *JANAR/SHKURT/MARS*							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare**	**Burimet**
Ngjarje muzikore **Vepra muzikore**	artistike nga krijimtaria artistike, popullore kombëtare dhe botërore të periudhave të ndryshme (se paku nga 3 për çdo periudhë stilistike-muzikore). Nxënësit njohin dhe emërojnë institucionet muzikore kombëtare dhe botërore të periudhave të ndryshme historike-stilistike muzikore. Nxënësit emërojnë dhe përshkruajnë e mundësisht vizitojnë institucionet muzikore në komunitet dhe vend.						

PERIUDHA (III)

MUAJT: *PRILL, MAJ, QERSHOR*

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

LËNDA MËSIMORE: ART MUZIKOR

KLASA: X

Tema mësimore: Këngë, interpretime me instrumente

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive..
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.
II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2. Dëshmim i vetëbesimit.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal.

I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë.
I.3. Interpreton individualisht ose në grup.
2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta.
2.2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.
2.3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike.
3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.
3.2. Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.
3.3.Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.
1.1. Komenton dhe shprehet për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, prezantim e forma të tjera shprehëse.

Tema mësimore: Elementet bazike të gjuhës artistike, shkrimi muzikor

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.
II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2. Dëshmim i vetëbesimit

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal.
I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më pare.
I.3. Interpreton individualisht ose në grup.
I.2.3. krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.
2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta.
2.2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të gjuhës artistike.
2.3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike.
3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.
3.2. Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.
3.3. Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.
1.2. Komenton dhe shprehet për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, prezantim e forma të tjera shprehëse.

Tema mësimore: Zhanre muzikore, gjinitë muzikore, instrumente dhe formacionet muzikore, krijues dhe performues

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:
I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2. Dëshmim i vetëbesimit.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Tema mësimore: Vepra artistike dhe ngjarje artistike

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:
3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.
4.1. Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.
1.3. Komenton dhe shprehet për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, prezantim e forma të tjera shprehëse.

PERIUDHA (III) MUAJT: *PRIL-MAJ-QERSHOR*							
Temat mësimore		**Njësitë mësimore**	**Koha e mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare**	**Burimet**
Këngë **Zhvillimi historik dhe stile muzikore**	Nxënësit këndojnë individualisht dhe ne grup këngë në tema dhe zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë etj.) me tematikë që i përshtatet interesit dhe moshës së nxënësve të klasës X (dashurisë, këngë patriotike, këngë popullore, këngë të lehta argëtuese për çaste festive etj.). Nxënësit këndojnë motive e tema të njohura të veprave muzikore vokale dhe instrumentale nga periudha të ndryshme stilistike. Nxënësit interpretojnë shoqërime këngësh dhe pjesë të vogla instrumentale sipas imitimit ose me tekst notal në zhanre të ndryshme që ata i preferojnë. Formojnë bendet muzikore, grupet e vallëzimit etj., sipas interesimit të tyre.	"Në qetësinë e natës", J. Brams Moj e bukura More Imagine – Xhon Lenon Muzika shqiptare në periudhën e rilindjes kombëtare Muzika instrumentale profesioniste shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XX Muzika vokale profesioniste shqiptare Muzika profesioniste kosovare Zhanri muzikor - xhaz, bluz, rok, e lehtë shqiptare dhe kosovare Muzika e filmit dhe e reklamave	17	Bisedë Diskutim *Brainstorming* Diagrami i Venit Harta e të pyeturit Kllaster Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli e nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë **Çështjet ndërkurrikulare** Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike	Teksti shkollor Softuerë arsimorë Cd Dvd

PERIUDHA (III) MUAJT: *PRIL-MAJ-QERSHOR*							
Temat mësimore		**Njësitë mësimore**	**Koha e mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare**	**Burimet**
Krijues dhe performues	Nxënësit dallojnë dhe njohin karakteristikat e zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, jaz, rok) përmes dëgjimit muzikor. Nxënësit dallojnë karakteristikat stilistike dhe fitojnë njohuri për artin muzikor në epoka të ndryshme, njohin veprat dhe përfaqësuesit më të rëndësishëm të atyre epokave. Nxënësit dallojnë instrumentet muzikore dhe formacionet karakteristike të periudhave të ndryshme historike. Nxënësit dallojnë krijuesit, performuesit dhe veprat artistike nga krijimtaria artistike, popullore kombëtare dhe botërore të periudhave të ndryshme (së paku nga 3 për çdo periudhë stilistike-muzikore).	Kompozitorë shqiptarë dhe të huaj Harta e një teatri muzikor Muzika dhe sporti, kërcimi Çmojmë veprimet gjatë një shfaqje artistike Çmojmë ngjarje artistike Çmojmë veprat muzikore - Opera "Don Zhuani" - Moxart				Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë Globalizimi dhe ndërvarësia Edukimi për media	

PERIUDHA (III) MUAJT: *PRIL-MAJ-QERSHOR*							
Temat mësimore		**Njësitë mësimore**	**Koha e mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare**	**Burimet**
Institucione muzikore **Ngjarje muzikore**	Nxënësit njohin dhe emërojnë institucionet muzikore kombëtare dhe botërore të periudhave të ndryshme historike-stilistike muzikore. Nxënësit emërojnë dhe përshkruajnë e mundësisht vizitojnë institucionet muzikore në komunitet dhe vend. Nxënësit dallojnë karakteristikat e veprës muzikore (formën, llojin, zhanrin përmbajtjen). Nxënësit emërtojnë përmes dëgjimit muzikor disa nga veprat e dëgjuara muzikore gjatë vitit (së paku 10). Nxënësit përjetojë dhe vlerësojë muzikën e epokave të ndryshme duke zhvilluar aftësitë e përjetimit estetik dhe vlerësimit kritik.						

PERIUDHA (III) MUAJT: *PRIL-MAJ-QERSHOR*							
Temat mësimore		**Njësitë mësimore**	**Koha e mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare**	**Burimet**
Vepra muzikore	Nxënësit komentojnë ngjarje të ndryshme nga jeta artistike kombëtare dhe botërore. Nxënësit marrin pjesë në koncerte, ngjarje muzikore, dokumentarë për krijues dhe interpretues muzikor. Nxënësit krijojnë CD me pjesët më të preferuara nga vepra të ndryshme muzikore klasike apo moderne.						

Planifikime ditore të lëndës, art muzikor, klasa 10 – njësi mësimore model

Planifikime ditore

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Art muzikor</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X (dhjetë)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor
Tema: “Format muzikore”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
Nxënësit dallojnë karakteristikat e formave muzikore si sonata, simfonia, koncerti, suita ne periudha te ndryshme historike e në zhanre e stile të ndryshme muzikore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive.
II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka.
V.2. Dëshmi e vetëbesimit.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të Avancuar.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Struktura muzikore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: strukturë muzikore, temë muzikore/motiv, frazë, fjali, periudhë, ritmi, përsëritja</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- krijon një motiv muzikor të personalizuar;
- imiton me zë ose fishkëllimë motive nga vepra të ndryshme muzikore;
- bën lidhje ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, dhe asaj që evidenton gjatë dëgjimit në një vepër muzikore;
- bën gjykime kritike ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore siç janë elementet muzikore që përbëjnë strukturën e melodisë;
- përdor një fjalor të thjeshtë muzikor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, mjete të tjera të parapërgatitura për të punuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Teknologjia dhe artet
Përdorimi i formave për të krijuar modele të ndryshme në përdorimin tonë të përditshëm.
Kuptimi i strukturës në forma të të përditshmes për të kuptuar si krijohet një vepër muzikore dhe vepra të tjera të artit.</td></tr>
</table>

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)
Hapi I
Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse (***brainstorming***) ku vendosen disa foto dhe një poezi dhe i kërkohet nxënësve të gjejnë elementin ritëm dhe motiv. Nxitet diskutimi rreth tyre.

Vendoset për t'u dëgjuar poezia e Fan Nolit "Anës lumenjve":
Ky ilaç e ky kushtrim
më bën djalë e më bën trim,
më jep forc' e më jep shpresë
anës Elbës, anës Spresë.
Se pas dimrit vjen një verë
që do kthehemi njëherë
pranë vatrës, pranë punës

Ritmi dhe motivi janë dy elemente që muzika, gjuha dhe arti i kanë të përbashkëta.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Hapi II - Elementet muzikore
Veprimtaria vazhdon duke shpjeguar se: në një krijim muzikor, pjesa më e rëndësishme është tema muzikore. Tema muzikore është një ide melodike. Me temë muzikore do të kuptojmë një fragment të vogël melodiko-ritmik të formuar të paktën nga dy tinguj muzikorë dhe me një ritëm të përcaktuar. Tipari kryesor i saj duhet të jetë i dallueshëm dhe të zërë vend në kujtesën e dëgjuesit.
Tema muzikore (motivi melodik ose melodia) është elementi kryesor mbi të cilin ndërtohen strukturat e ndryshme muzikore dhe përcaktohen format muzikore. Përsëritja e temës ose kombinimi i tyre kontribuojnë në klasifikimin e formave muzikore.
Ritmi përfshin kohëzgjatjen ose gjatësinë e tingullit muzikor. Koha dhe shpejtësia në të cilën një pjesë muzikore luhet, quhet ritëm. Karakteristikat e ritmit janë goditja ose vazhdueshmëria, koha dhe theksi. Kur ritmet janë kombinuar në grupe me nga dy, tri ose më shumë goditje brenda një mase muzikore, rezultati është koha (p.sh. ¾).

Harmonia ka të bëjë me mënyrën se si akordet janë ndërtuar dhe se si ndjekin njëri-tjetrin. Një akord është bashkëtingëllimi i tri ose më shumë notave.
Përsëritja dhe kontrasti, struktura e brendshme e një pjese muzikore dhe parimet e formësimit janë kritere bazë që përdoren për të klasifikuar format muzikore. Në një krijim muzikor, idetë nuk janë të vendosura pa një lidhje logjike kompozicionale, rregulli dhe sistemimi i tyre ngjan me një diskutim muzikor. Brenda një pjese muzikore, meloditë mund të jenë të barabarta, të ngjashme ose të ndryshme. Dallimi dhe mbajtja mend e tyre nga dëgjuesi arrihet nëpërmjet përsëritjes.

Hapi III
Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja vendos në Cd *Koncert Nr. 1 OP. 23*, për piano dhe orkestër, Kompozitor: P. Çajkovski.
-
- **Hapi IV**
- Duke dëgjuar muzikë, nxiten nxënësit të evidentojnë karakteristikat e motivit, temës dhe përsëritjes së tij. Nxënësit:
- identifikojnë motivin, temën muzikore dhe përsëritjen në veprat e dëgjuara;
- diskutojnë lidhur me njohuritë që morën duke respektuar mendimin e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësve:
Tregohet nga rezultatet e arritura të nxënësve në:
- krijimin e një motivi muzikor të personalizuar;
- imitimin me zë ose fishkëllimë të motiveve nga vepra të ndryshme muzikore;
- lidhjen ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, dhe asaj që evidenton gjatë dëgjimit në një vepër muzikore;
- gjykimin kritik ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore, siç janë elementet muzikore që përbëjnë strukturën e melodisë;
- përdorimin e një fjalori të thjeshtë muzikor.

Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit të vlerësojnë njohuritë e tyre mbi veprat muzikore dhe të artit duke folur për ndërtimin e strukturës që ato kanë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me mësimin e ri mbi strukturën muzikore dhe elementet e saj.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor **Tema:** Format muzikore		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësit dallojnë karakteristikat e formave muzikore si sonata, simfonia, koncerti, suita në periudha të ndryshme historike e në zhanre e stile të ndryshme muzikore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.			

IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka.
V.2. Dëshmi e vetëbesimit.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Format 1-2-3 pjesëshe

Fjalët kyçe: forma njëpjesëshe, forma dypjesëshe, forma tripjesëshe, kënga, balada, madrigali.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- kupton formën 1-2-3 pjesëshe në muzikë;
- evidenton dhe përshkruan karakteristikat e formave muzikore gjatë dëgjimit;
- gjen lidhjen midis formave muzikore dhe formave në art dhe në arkitekturë;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët;
- respekton këngë të kulturave të tjera.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
- Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Shembuj muzikore të parapërgatitura në Cd, magnetofon, materiale nga interneti

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Teknologjia dhe artet
Përdorimi i formave për të krijuar modele të ndryshme në përdorimin tonë të përditshëm.
Kuptimi i strukturës në forma të të përditshmes për të kuptuar se si krijohet një vepër muzikore dhe vepra të tjera të artit.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I
Mësimi nis me dy veprimtari konkrete. Në fillim vëzhgohen dhe diskutohet për fotove në tekstin e nxënësit, ndërsa në veprimtarinë e dytë (stili dëgjimor), mësuesi/ja vendos në Cd *Salut d'amour, Op.12 (Elgar, Edëard).*
Nxënësit dëgjojnë me kujdes.
Pasi kënga përfundon evidentohen disa nga karakteristikat e melodisë.
Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth këtyre karakteristikave.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)
Hapi II
Në këtë pjesë të orës, mësuesi/ja shpjegon format 1, 2, dhe 3 pjesëshe.
Forma njëpjesëshe është organizimi më i thjeshtë dhe më i vogël muzikor, ku mendimi muzikor paraqitet si një periudhë e vetme që përsëritet disa herë mbi kriterin e përsëritjes së njëjtë. Prej saj rrjedhin lloje të veçanta këngësh, baladash, të ndërtuara në formën e një strofe (ose me disa strofa). Balada është një formë e këngës tregimtare (narrative) italiane e shek. 13-15 dhe nuk ka të bëjë me vallen ose me emrin e formës instrumentale të viteve 1800.
Forma dypjesëshe: krijimi muzikor është i përbërë nga dy melodi muzikore të ndryshme, atëherë e përcaktojmë si formë dypjesëshe. Duke u bazuar në parimin e përsëritjes së njëjtë dhe të ndryshuar të së njëjtës melodi, apo dhe të parimit të kontrastit, materiali muzikor i nënshtrohet një ecurie logjike, e cila përfshin gjithë formën duke krijuar një të tërë. Shumë "kërcime instrumentale" të shekullit XVI-XVII janë të ndërtuara në formën dypjesëshe.

Forma trepjesëshe. Struktura kompozicionale në këtë formë është e thjeshtë, pasi prezanton dy periudha kryesore A dhe B, që tani mund t'i quajmë **tema** dhe është e ndarë në tri pjesë simetrike. Në pjesën e parë A **tema** (një periudhë) mund të përsëritet dy herë, por me intensitet të ndryshëm. Në partin qendror është prezantuar një temë e re, **tema** B në kontrast me dy pjesët A, dhe në pjesën e tretë A përsëritet. Përsëritja mund të jetë njësoj ose e ndryshuar.
Matematikisht, një formë e strukturuar kështu, është trepjesëshe.

Hapi III
Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja vendos në Cd *Minuet - Luigi Boccherini - String Quintet in E Major, Op.11 No.5.*
-
- **Hapi IV**
- Duke dëgjuar muzikën, nxënësit nxiten të evidentojnë karakteristikat e minuetit:
- - karakterin e tij;
- - çfarë përfaqësonin ato për kohën;
- - motivin;
- instrumentet që luhet.

Nxënësit diskutojnë lidhur me njohuritë që morën duke respektuar mendimin e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve e arritura të nxënësve në:
- shpjegimin e karakteristikave të formës 1, 2, 3 pjesëshe në muzikë gjatë dëgjimit;
- gjetjen e lidhjeve midis formave muzikore dhe formave në art e arkitekturë;
- ndërtimin dhe argumentimin me raste reale se si ndikon muzika në moment të vështira të jetës njerëzore;
- krijimin e mendimit krijues personal, i nxitur nga përqendrimi dhe zhvillimi i të menduarit gjatë dëgjimit muzikor;
- respektimin e mendimit të mendimit të shokëve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë një këngë dhe të përshkruajnë se si ndihen kur e dëgjojnë.
Krijim (Punë individuale): Cd me pjesë muzikore; minuete, madrigale dhe këngë nga kompozitorë të ndryshëm. Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re (format 1-2-3 pjesëshe).

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësit këndojnë individualisht dhe në grup, këngë në tema dhe zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë etj.) me tematikë që i përshtatet interesit dhe moshës së nxënësve të klasës X (dashurisë, këngë patriotike, këngë popullore, këngë të lehta argëtuese për çaste festive etj.).	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka.
V.2. Dëshmi e vetëbesimit.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
1.1. Performojnë pjesë (këngë, valle, pjesë teatrale) të formave, gjinive dhe zhanreve të ndryshme muzikore, duke aplikuar teknika më të avancuara interpretuese dhe kombinuar teknikat interpretuese në disiplinat e ndryshme artistike.
1.3. Prezantojnë aftësitë e tyre krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Zëri dhe rregullat e këndimit

- **Fjalët kyçe:** soprano, tenor, mexosoprano, bariton, bas, alto, korda, laringu.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- evidenton karakteristikat e zërave – vokalit;
- shpjegon llojet e zërave;
- argumenton interpretimin artistik gjatë këndimit;
- krijon Cd (punë individuale) me arie nga opera të ndryshme;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve;
- këndon vetëm dhe në grup.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, magnetofon, materiale nga interneti

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Gjuhët dhe komunikimi, letërsia
Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve "formacione muzikore vokale dhe instrumentale".

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve
Hapi I
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos në Cd disa fragmente nga arie të ndryshme dhe nxënësit përcaktojnë llojet e zërave që dëgjojnë: burrë, grua, vajzë, djalë etj.
Nxiten nxënësit të diskutojnë **rreth** ngjashmërive dhe ndryshimeve që i përkasin: zërave apo mënyrës së këndimit, duke gjykuar sipas njohurive që kanë.

Hapi II
Nxënësve u kërkohet të bëjnë:
- përshkrimin e karakteristikat të të kënduarit të këngëtarëve, edhe pse mund të këndojë në të njëjtën gjini apo rrymë muzikore;
- argumentimin e ngjashmërive apo ndryshimeve që dëgjon gjatë interpretimit të tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja 30 minuta
Hapi III

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja shpjegon rreth **zërit** dhe **dëgjimit,** dy organeve që kryejnë funksione që lidhen ngushtë me njëri-tjetrin. Zëri është instrumenti më i përsosur që natyra ka krijuar te njeriu. Nëpërmjet tij, njeriu imiton çdo tingull, kurse asnjë instrument nuk mund të imitojë zërin e njeriut. Por si krijohet zëri?



Zëri nxirret prej kordave vokale të cilat janë të vendosura në pjesën e sipërme të qafës, pikërisht te laringu (kanali që sjell ajrin nga goja në mushkëri). Kur thithim ajrin, kordat vokale qëndrojnë të hapura e të shtendosura. Por kur flasim ose kur këndojmë, kordat vokale tendosen, afrohen dhe gati mbyllen, duke lënë vetëm një hapësirë të ngushtë, nëpër të cilën kalon ajri, dhe shkakton dridhjen e tyre.

Pjesët përbërëse të organit të të folurit që ju shikoni në figurën në të majtë, janë pjesët që na mundësojnë të flasim dhe të këndojmë. Duke qenë se këto organe janë të ndryshme te çdo njeri, krahas fuqizimit ato i japin zërit ngjyrë (timbër) të veçantë për secilin prej nesh. Aq e veçantë është kjo ngjyrë sa dy njerëz nuk kanë të njëjtin timbër zëri. Nëpërmjet timbrit/ngjyrimit të zërit, ne bëjmë klasifikimin e zërave në meshkuj, femra dhe fëmijë, që ndryshe cilësohen si zëra të bardhë.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve e arritura të nxënësve në:
- evidentimin e karakteristikave të zërave – vokalit;
- shpjegimin e llojeve të zërave;
- argumentimin e interpretimit artistik gjatë këndimit;
- krijimit të Cd (punëve individuale) me arie nga opera të ndryshme;
- ndërtimin dhe argumentimin me raste reale se si ndikon muzika në moment të vështira të jetës njerëzore;
- për respektimin e mendimit të mendimit të shokëve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Krijim individual: kërkim nga burime të ndryshme muzikore interpretime nga këngëtarë të ndryshëm (Cd). Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësit këndojnë individualisht dhe në grup këngë në tema dhe zhanere të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë etj.) me tematikë që i përshtatet interesit dhe moshës së nxënësve të klasës X (dashurisë, këngë patriotike, këngë popullore, këngë të lehta argëtuese për çaste festive etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. V.2. Dëshmi e vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

1.2. Performojnë pjesë (këngë, valle, pjesë teatrale) të formave, gjinive dhe zhanreve të ndryshme muzikore, duke aplikuar teknika më të avancuara interpretuese dhe kombinuar teknikat interpretuese në disiplinat e ndryshme artistike.

1.3. Prezantojnë aftësitë e tyre krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Këngë "Lule bore"

Fjalët kyçe: Tekst i këngës, melodi, interpretim, jare

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- komunikon qartë informacionin që ka për jaret shkodrane;
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve;
- këndon vetëm dhe në grup.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, magnetofon, materiale nga interneti

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi: letërsia.

Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve "kulturë", jare", tradita, festa kombëtare etj.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi nis me një ***brainstorming*** ku vendoset ku mësuesi/ja vendos dy simbole ose fotografi/postera të ndryshëm: fjalë të ndryshme dhe nota muzikore. Nxënësve u kërkohet që të flasin për emocionet që përcjellin arti i fjalës dhe i muzikës. Diskutimet ndihmojnë që ata/ato të kuptojnë vetë se sa e rëndësishme është gjuha në jetën tonë të përditshme.

Ndërtimi i njohurive të reja

Vazhdohet puna me mësimin e këngës "Lule bore", duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.

Më pas bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në Cd;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësuesi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave;
- përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.

Lule bore

Tuj shetitur n'mal e n'koder,
tuj prek lulet t'gjith' me dor',
veç n'nji kopsht ma t'bukurin
n'Shkodër,
ty të gjeta lulebor'.

Je e vogël, por e plot',
ty t'kërkoj un tash sa mot,
tash sa mot un ty t'kërkoj,
vij me ty jetën ta coj,

Eja, eja lulebor',
se me ty do thur kunor.
Eja, eja lulebor',
se me ty do thur kunor.

Pash' ma t'buk'rën stinë
t'pranverës
Pashë ma t'buk'rin drandofill!
Mos t'ja falish kujt ti erën
se për mu vetëm ke çilë!

Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve e arritura të nxënësve në: - diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me këngën e re; - këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit; - interpretimin e këngës me emocion; - bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës); - këndimin korrekt në ritëm dhe në intonacion.
Detyrat dhe puna e pavarur
Nxënësit **dëgjojnë** disa herë të këngën dhe përshkruajnë atë që përjetojnë.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re (këndimin në ritëm dhe intonacion deri në përkryerje artistike).

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësit këndojnë individualisht dhe në grup këngë në tema dhe zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë etj.) me tematikë që i përshtatet interesit dhe moshës së nxënësve të klasës vX (dashurisë, këngë patriotike, këngë popullore, këngë të lehta argëtuese për çaste festive etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. V.2. Dëshmi e vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2. Performojnë pjesë (këngë, valle, pjesë teatrale) të formave, gjinive dhe zhanreve të ndryshme muzikore, duke aplikuar teknika më të avancuara interpretuese dhe kombinuar teknikat interpretuese në disiplinat e ndryshme artistike. 1.3. Prezantojnë aftësitë e tyre krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Këngë "Në qetësinë e natës"			
- **Fjalët kyçe:** korale, melodia e këngës, teksti i këngës, rregullat e këndimit, muzika kishtare.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - komunikon qartë informacionin që ka për muzikën kishtare të periudhës në të cilën është krijuar koralja; - këndon në grup duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara në grup; - interpreton koralen me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, magnetofon, materiale nga interneti

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Gjuhët dhe komunikimi: letërsia.
Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve "muzikë e kënduar", "korale" etj.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete stili dëgjimor ku mësuesi/ja në Cd këngën "Në qetësinë e natës"

Ndërtimi i njohurive të reja
Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me (**hapin II),** ku mësuesi/ja **vendos** në Cd për dëgjim këngën: "Në qetësinë e natës"

- **Nxiten** nxënësit të flasin rreth karakteristikave që ka të kënduarit në kor/grup dhe karakteristikat e vetë melodisë.
- **Më pas** lexohen me kujdes fjalët e korales pasi ato janë në latinisht, duke u kujdesur të vendoset theksi i fjalës aty ku duhet.

I
Muzgu i mbrëmjes së qet'
të pushojmë na thërret.
Gjum' i ëmbël të pushtoj'
gjersa dita t'agoj.
Kopshti ra n'qet'si,
vogëlush fli dhe ti.
Kopshti ra në qet'si,
Vogëlush fli dhe ti.
II
Nat' e mir' o malli im,
përmbi lule pusho.
Ëndërro, ti ëndërro,
bashk' me lulet u zgjo.
Dhe mëngjesi plot diell,
plot të mira na sjell.
Dhe mëngjesi plot diell,
plot të mira na sjell.

Më pas bëhet:
- dëgjimi i vijës melodike të këngës në Cd;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- demonstrimi i këngës nga mësuesi/ja dhe krijimi i gadishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave;
- përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.

Vlerësimi
Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve e arritura të nxënësve në:
- komunikimin qartë të informacionit që kanë për muzikën kishtare;
- këndimin në grup duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara në grup;
- interpretimin e korales me ndjenjë dhe emocion sipas karakterit të veprës;
- respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve.

Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit të **dëgjojnë** disa herë të këngën dhe të krijojnë e një **Ese/Krijim individual:**
a) kërkim nga burime të ndryshme muzikore mbi këtë mënyrë të kënduari;
b) përshkrim i emocioneve nga këngë të ndryshme, gjetur nga rrjete të ndryshme internet dhe dëgjuar me kujdes.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re (këndimin në ritëm dhe intonacion deri në përkryerje artistike).

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësit këndojnë individualisht dhe ne grup këngë në tema dhe zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë etj.) me tematikë që i përshtatet interesit dhe moshës së nxënësve të klasës X (dashurisë, këngë patriotike, këngë popullore, këngë të lehta argëtuese për çaste festive etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. V.2. Dëshmi e vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Performojnë pjesë (këngë, valle, pjesë teatrale) të formave, gjinive dhe zhanreve të ndryshme muzikore, duke aplikuar teknika më të avancuara interpretuese dhe kombinuar teknikat interpretuese në disiplinat e ndryshme artistike. 1.3. Prezantojnë aftësitë e tyre krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Këngë "Moj e bukura more"			
- **Fjalët kyçe:** këngë arbëreshe, melodia e këngës, teksti i këngës, rregullat e këndimit muzika arbëreshe.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - shpjegon me argumente ikjen e shqiptarëve në Itali dhe ruajtjen e traditave dhe zakoneve; - këndon këngën duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; - këndon vetëm dhe në grup.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, magnetofon, materiale nga interneti			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuhët dhe komunikimi: letërsia. Shkenca dhe mjedisi: Shkenca dhe shoqëria: Historia, gjeografia, letërsia, arti pamor Artet: Arti pamor Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve "Letërsia arbëreshe", " poezi", "shkrimtarë", "kostumet" etj.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete, ***brainstorming,*** ku mësuesi/ja shkruan disa fjalë kyçe:
Arbëri
Arbëresh
Gjuha arbëreshe
Veshjet arbëreshe
Mbi këto fjalë fillon rikujtimi nga mësimet e historisë, fakte nga ikja e 500 mijë shqiptarëve drejt Italisë pas vdekjes së Skënderbeut dhe humbjes së luftërave.
Flitet për Arbërinë dhe arbëreshët, traditat dhe zakonet e tyre të cilat janë ruajtur ndër shekuj.

Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me **hapin II,** ku mësuesi/ja **vendos** në Cd këngën " Moj e e bukura More". **Nxiten** nxënësit të flasin rreth karakteristikave që ka të kënduarit arbëresh dhe karakteristikat e vetë melodisë.

Moj e bukura More

Moj e bukura More
si të lash' e më s'të pash'
si të lash', si të lash'
siç të gjeta nuk të lash'
Atje kam unë zotin At'
atje kam unë zonjën Mëmë
atje kam dhe tim vëlla
të gjithë mbuluar
të gjithë mbuluar
të gjithë mbuluar nën dhe
Moj e bukura More...

Më pas bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në Cd;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- demonstrimi i këngës nga mësuesi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave;
- përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Gjatë mësimit të këngës tregohet kujdes për respektimin e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve e arritura të nxënësve në:

- këndimin e këngës duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
- respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve;
- këndimin vetëm dhe në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë këngën disa herë dhe të krijojnë një **ese/krijim individual:** a) kërkim nga burime të ndryshme muzikore interpretime nga këngëtarë të ndryshëm arbëreshë (krijim i Cd) ose b) përshkrim i emocioneve nga këngë të ndryshme arbëreshe.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me mësimin e ri (këndimi në ritëm dhe intonacion deri në përkryerje artistike).

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësit këndojnë individualisht dhe ne grup këngë në tema dhe zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë etj.) me tematikë që i përshtatet interesit dhe moshës së nxënësve të klasës X (dashurisë, këngë patriotike, këngë popullore, këngë të lehta argëtuese për çaste festive etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. V.2. Dëshmi e vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2. Performojnë pjesë (këngë, valle, pjesë teatrale) të formave, gjinive dhe zhanreve të ndryshme muzikore, duke aplikuar teknika më të avancuara interpretuese dhe kombinuar teknikat interpretuese në disiplinat e ndryshme artistike. 1.3. Prezantojnë aftësitë e tyre krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Koralja "Oda e g'zimit"			
- **Fjalët kyçe:** korale, melodia e këngës, teksti i këngës, rregullat e këndimit, himn. **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:** - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; - interpreton koralen me ndjenjë dhe emocion; - këndon në ritëm dhe intonacion.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, magnetofon, materiale nga interneti			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkenca dhe mjedisi: Historia, gjeografia			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete, **brainstorming**, ku mësuesi/ja shkruan disa fjalë kyçe:
BE
Bethoven
Simfonia e 9-të

Përmes fjalëve kyçe, nxënësit flasin rreth BE dhe pse është e rëndësishme për shqiptarët hyrja në BE.
Ata rikujtojnë himnin evropian, nëse e dinë, i cili është shkëputur nga simfonia 9-të e Bethovenit.

Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II
Dëgjojnë koralen "Oda e g'zimit" në Cd. Përmes saj, nxënësit nxiten të flasin rreth muzikës himn.

Më pas bëhet:
- dëgjimi i vijës melodike të këngës në Cd;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- demonstrimi i këngës nga mësuesi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave;
- përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Oda e gëzimit

Gzim ti je i mrekullushëm
gjithmon' jetën ti stolis,
n' pragun tënd o të magjishëm
gjithmonë jetën ti stolis.

Refreni
Se atë që mbyt mërzia
ti sërish e gjallëron,
vllazërohet njerëzia
flatra jote nuk pushon.

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.

Vlerësimi
Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve e arritura të nxënësve në:
- këndimin e këngës duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
- respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve;
- këndimin vetëm dhe në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë këngën disa herë dhe të krijojnë një **ese/krijim individual:**
a) kërkim nga burime të ndryshme muzikore nga muzika e Bethovenit (krijim me vepra muzikore të tij - Cd) ose
b) përshkrim i emocioneve nga muzika e këtij kompozitori.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me mësimin e ri (këndimi në ritëm dhe intonacion deri në përkryerje artistike).

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësit këndojnë individualisht dhe ne grup këngë në tema dhe zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë etj.) me tematikë që i përshtatet interesit dhe moshës së nxënësve të klasës X (dashurisë, këngë patriotike, këngë popullore, këngë të lehta argëtuese për çaste festive etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. V.2. Dëshmi e vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Performojnë pjesë (këngë, valle, pjesë teatrale) të formave, gjinive dhe zhanreve të ndryshme muzikore, duke aplikuar teknika më të avancuara interpretuese dhe kombinuar teknikat interpretuese në disiplinat e ndryshme artistike. 1.3. Prezantojnë aftësitë e tyre krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kënga “Imagine”			
- **Fjalët kyçe:** melodia e këngës, teksti i këngës, rregullat e këndimit **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore** **Nxënësi/ja:** - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; - interpreton koralen me ndjenjë dhe emocion; - këndon në ritëm dhe intonacion.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, magnetofon, materiale nga interneti			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuhët dhe komunikimi: letërsia. Shkenca dhe mjedisi: Shkenca dhe shoqëria: Historia, gjeografia, letërsia, arti pamor Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “muzika moderne”, “rok”, “Beatles”, “fovizmi” etj.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve **Hapi I** Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ***brainstorming***, ku mësuesi/ja shkruan disa fjalë kyçe Shekulli XX Muzika moderne Muzika rok Jon Lenon Betales			

Ndërtimi i njohurive të reja
Hapi II
Dëgjojnë koralen "Imagine" në Cd. Përmes saj, nxënësit nxiten të flasin rreth muzikës së Beatles dhe grupit të tyre.

Më pas bëhet:
- dëgjimi i vijës melodike të këngës në Cd;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- demonstrimi i këngës nga mësuesi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave;
- përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.

"Imagine"

Imagine there's no heaven
It's easy if you try
No hell below us
Above us only sky
Imagine all the people
Living for today... Aha-ah...
Imagine there's no countries
It isn't hard to do
Nothing to kill or die for
And no religion too
Imagine all the people
Living life in peace... You,..
You may say I'm a dreamer
But I'm not the only one
I hope someday you'll join us
And the world will be as one
Imagine no possessions
I wonder if you can
No need for greed or hunger
A brotherhood of man
Imagine all the people
Sharing all the world... You,..
You may say I'm a dreamer
But I'm not the only one
I hope someday you'll join us
And the world will be as one

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve e arritura të nxënësve në:

- këndimin e këngës duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
- respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve;
- këndimin vetëm dhe në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë këngën disa herë dhe të krijojnë një **ese/krijim individual:**

c) kërkim nga burime të ndryshme muzikore nga muzika e Beatles (krijim me këngë nga ky grup muzikor - Cd) ose
d) përshkrim i emocioneve nga muzika e Xhon Lenon.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me mësimin e ri (këndimi në ritëm dhe intonacion deri në përkryerje artistike).

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** Zhvillimi historik i zhanreve dhe stileve muzikore		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësit dallojnë dhe njohin karakteristikat e zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, jaz, rok) përmes dëgjimit muzikor. Nxënësit dallojnë karakteristikat stilistike dhe fitojnë njohuri për artin muzikor në epoka të ndryshme, njohin veprat dhe përfaqësuesit më të rëndësishëm të atyre epokave.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. V.2. Dëshmi e vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.1. Identifikojnë dhe elaborojnë me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror. 3.2. Përcaktojnë ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë. 3.3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit. 3.4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Muzika në Mesopotami, Egjipt, Indi dhe Kinë			
- **Fjalët kyçe:** instrument muzikor oud, tanpuran, liuti			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - - shpjegon shtrirjen gjeografike, kulturore, ekonomike të vendeve ku u zhvilluan qytetërimet e para; - - dëgjon dhe argumenton llojin e muzikës dhe instrumentet që ekzekutonin në atë periudhë; - - gjykon nëpërmjet fakteve se si ishte e zhvilluar muzika në moment të vështira të jetës njerëzore; - respekton mendimin e shokëve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, magnetofon, materiale nga interneti			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkenca dhe mjedisi, histori, gjeografi Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme mbi muzikën në lashtësi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve **Hapi I** Mësimi nis me një veprimtari konkrete **"brainstorming",** ku mësuesi/ja vendos ose shkruan në dërrasë: hartën e qytetërimeve të lashta që tregon shtrirjen gjeografike të qytetërimeve të lashta; kulturën e qytetërimeve të lashta; prodhimet dhe ekonomia e qytetërimeve të lashta.			

(Janë disa fjalë kyçe apo kërkesa të drejtuara nga mësuesi/ja që i nxisin nxënësit diskutojnë në klasë rreth e qytetërimeve të lashta karakteristikat kulturore, arkitektonike, historike etj.)

Hapi II
Vendoset fragmenti muzikor (Cd) "Himni i Muzës" nga Mesomedi i Kretës.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Hapi III
Ndërkohë shpjegohen **fillimet e muzikës në Antikitet** e cila është periudha gjatë së cilës muzika filloi të merrte kuptimin e një veprimtarie që zhvillohej nga njerëz të veçantë, pavarësisht se ajo ishte shumë e thjeshtë dhe u zhvillua kryesisht në përbërje të tragjedisë e të komedisë antike. Muzika ishte pjesë përbërëse e teatrit antik, art që zhvillohej nga loja e aktorit, skena të ndryshme, regjisori. Ajo edhe pse shoqëronte dhe pasqyronte figurat teatrore, u zhvillua duke krijuar mundësinë që të zhvillohej si art më vete. Këtë gjë e dëshmojnë materialet e gjetura të historianëve; mbishkrimet e monumenteve, basoreliefet apo pikturat murale të cilat na ndihmojnë të zbulojmë dhe kuptojmë se si është zhvilluar bota misterioze e muzikës së antikitetit. Që në lashtësi kënga, fjala, muzika dhe kërcimi kanë qenë të pandara, ndaj themi që arti në ishte sinkretik, pasi ai zhvillohej bashkë pra ishte i përbashkët dhe i shumëfishtë. Ndërsa mjetet shprehëse lidheshin me mundësitë shprehëse të vetë trupit të njeriut të cilat përbënë edhe mjetet e para muzikore p.sh.: zëri, përplasja e duarve, bashkëveprimi me mjete rrethanore si druri, guri etj. Njeriu nëpërmjet lëvizjeve, zërit apo shoqërimit me mjete të ndryshme manifestonte emocionet e tij vetëm ose në mënyrë kolektive, duke shprehur format e para të shfaqjeve muzikore.
Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me (**hapin IV),** ku mësuesi/ja vendos disa foto duke parë me kujdes fotot imagjinoni se si mund të ketë qenë jeta në qytetërimet e lashta.
- Nxiten nxënësit të shkruajnë shkurtimisht rreth tyre.

Hapi V
Vendosen fragmente muzikore (Cd me melodi egjiptiane) nga kjo periudhë dhe nxënësit shprehin mendimin e vet rreth tyre:
Çfarë lloj emocioni u krijohet? Si do ta përcaktonin me fjalët e veta këtë lloj muzike?
Nxënësit mund të sjellin edhe vetë melodi të ndryshme gjetur nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në internet, këngë apo muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë. Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.

Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura të nxënësve në:
- evidentimin e shtrirjes gjeografike dhe zhvillimin kulturor, ekonomik të vendeve ku u zhvilluan qytetërimet e para;
- argumentimin pas dëgjimit në Cd të llojeve të muzikës dhe instrumenteve që ekzekutojnë në atë periudhë;
- gjykimit nëpërmjet fakteve se si ishte e zhvilluar muzika në qytetërimet e lashta;
- respektimin e mendimit të shokëve;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të kryejnë një **kërkim:**
Gjeni materiale nga burime informacioni të ndryshme duke zgjeruar njohuritë rreth muzikës në antikitet.
Nga gjetjet mund të krijoni albume ose Cd me muzikë kësaj periudhe.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me mësimin e ri.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** Zhvillimi historik i zhanreve dhe stileve muzikore		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësit dallojnë dhe njohin karakteristikat e zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, jaz, rok) përmes dëgjimit muzikor. Nxënësit dallojnë karakteristikat stilistike dhe fitojnë njohuri për artin muzikor në epoka të ndryshme, njohin veprat dhe përfaqësuesit më të rëndësishëm të atyre epokave.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. V.2. Dëshmi e vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.1. Identifikojnë dhe elaborojnë me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror. 3.2. Përcaktojnë ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë. 3.3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit. 3. 4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kultura muzikore gjatë Rilindjes			
- **Fjalët kyçe:** Rilindje, monodi, fraza muzikore, polifoni **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore** **Nxënësi/ja:** - - shpjegon ngjarjet që lidhen me periudhën e Rilindjes dhe zhvillimi muzikor; - - shpjegon ndryshimet që ndodhën në art, muzikë, shkencë etj., duke analizuar faktet e kohës; - - argumenton duke krahasuar muzikën e kësaj periudhe me një periudhë tjetër, dhe nxjerr karakteristikat e saj; - respekton mendimin e shokëve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, magnetofon, materiale nga interneti			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkenca dhe mjedisi, historia, gjeografia Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme mbi muzikën në Rilindje			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve **Hapi I** Mësimi nis me një veprimtari konkrete "stili dëgjimor" ku mësuesi/ja vendos në Cd një pjesë muzikore "Klithmat e Parisit" e K. Zhankë. Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth muzikës që dëgjojnë, duke diskutuar rreth llojit muzikor që ata dëgjojnë.			

Shkruhen fjalë kyçe
Galileo Galileu
Nikolla Koperniku
Rilindje
Mikelanxhelo
Rafaelo
Fjalët kyçe shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth ngjarjeve në tërësi të kësaj periudhe mbi shkencën, artin etj., dhe të nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Hapi II
Ndërkohë shpjegohet Arti muzikor ose ndryshe periudha e quajtur Rilindje. Ajo u zhvillua gjatë shekullit XV dhe XVI. Gjatë kësaj periudhe u shënuan arritje të mëdha në të gjitha fushat art, letërsi, muzikë, ekonomi. Zbulimet e mëdha gjeografike dhe ekonomike në shekujt XV dhe XVI po e çonin Evropën Perëndimore drejt ndryshimeve shoqërore, historike, kulturore e artistike. Në këtë epokë mbizotëroi lëvizja humaniste, e cila shoqëroi të gjithë periudhën që sot njihet me emrin Rilindje. Në këtë periudhë njerëzit filluan të ndjehen të lirë për të shprehur idetë e tyre intelektuale, kulturore, artistike e shkencore për ndryshime, të cilat sollën zhvillime shumë të mëdha në shkencë. Për herë të parë në këtë periudhë shkenca iu kundërvu parimeve fetare, të cilat ishin respektuar në mënyrë shumë të rreptë deri në atë kohë.
-
- Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me **hapin III**, ku mësuesi/ja vendos disa foto me vepra arti të kësaj periudhe **(Reflektimi).** Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht:

1. Pse gjatë kësaj periudhe njerëzit filluan të shprehnin lirshëm idetë e tyre nëpërmjet arteve të ndryshme? Cilët ishin përfaqësuesit kryesore?
2. Pse themi se në këtë periudhë u bë qartësimi i muzikës polifonike pa ndikimin e muzikës kishtare?
-
Ata përgjigjen duke dhënë mendimet e veta si dhe duke ballafaquar me njohuritë që morën.

Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura të nxënësve në:

- - shpjegimin e ngjarjeve që lidhen me periudhën e Rilindjes dhe zhvillimin muzikor;
- - shpjegimin e ndryshimeve që ndodhën në art, muzikë, shkencë etj., duke analizuar faktet e kohës;
- - argumentimin duke krahasuar muzikën e kësaj periudhe me një periudhë tjetër, dhe nxjerrë karakteristikat e saj;

- respektimin e mendimit të mendimit të shokut.

Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit të kryejnë një **kërkim:**
Gjeni materiale nga burime informacioni të ndryshme duke zgjeruar njohuritë rreth muzikës në Rilindje. Nga gjetjet mund të krijoni albume ose Cd me muzikë kësaj periudhe.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me mësimin e ri.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** Zhvillimi historik i zhanreve dhe stileve muzikore		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësit dallojnë dhe njohin karakteristikat e zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, jaz, rok) përmes dëgjimit muzikor. Nxënësit dallojnë karakteristikat stilistike dhe fitojnë njohuri për artin muzikor në epoka të ndryshme, njohin veprat dhe përfaqësuesit më të rëndësishëm të atyre epokave.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. V.2. Dëshmi e vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.1. Identifikojnë dhe elaborojnë me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror. 3.2. Përcaktojnë ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë. 3.3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit. 3. 4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kultura muzikore gjatë periudhës së Klasicizmit			
- **Fjalët kyçe:** klasicizëm, opera seria, opera bufa, simfonia, sonata, trio.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - - shpjegon ngjarjet historike, artistike, ekonomike, politike, që lidhen me periudhën e Klasicizmit; - - shpjegon risitë e periudhës dhe zhvillimet e mëtejshme që ndodhën në muzikë (opera bufa, seria, gjinitë e reja që lindën); - - argumenton duke krahasuar një vepër të kësaj periudhe me një vepër muzikore të periudhës Barok, duke renditur disa karakteristika; - - krijon linjën e kohës në të cilën u zhvillua muzika, gjinitë e ndryshme, instrumentet dhe përfaqësuesit duke e prezantuar në klasë; - respekton mendimin e shokëve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, magnetofon, materiale nga interneti			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkenca dhe mjedisi, histori, gjeografi Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme mbi muzikën në Klasicizëm.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete "stili dëgjimor", ku mësuesi/ja vendos në Cd kohën e parë të simfonisë – *molto allegro*.

Pasi nxënësit e dëgjojnë, nxiten të diskutojnë rreth muzikës që dëgjuan, muzikë e cila nga vetë karakteri është mjaft alegro si melodi. Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si e përjetoni ju melodinë?
- Dinamikat përgjatë melodisë janë forte-piano?
- Tingëllimi shumë i shpejtë i tingujve që herë ngjiten lart dhe herë zbresin poshtë.

Hapi II: Brainstorming

Vendosen disa foto nga Revolucioni francez/Napoleon Bonaparti dhe ngjarje të tjera të asaj periudhe, dhe nxënësit diskutojnë më gjerë rreth tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

- Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me (**hapin IV),** ku mësuesi/ja shpjegon nëpërmjet teknikës **Harta e të pyeturit/Kubimi** rreth zhvillimeve muzikore gjatë kësaj periudhe.

Gjysma e dytë e shek. XVIII njohu një revolucion të vërtetë të mendimit dhe të ideve. Kjo lëvizje me emrin iluminizëm (ndriçoj) nuk lindi rastësisht, por i pati rrënjët në ndryshimet ekonomiko-shoqërore që ndodhën si pasojë e revolucioneve borgjeze, veçanërisht të Revolucionit Borgjez Francez (1789) dhe të Revolucionit Amerikan (luftës për pavarësi 1776–1783).

Iluminizmi kishte si qëllim të ndriçonte mendjen e njerëzve për t'u larguar nga injoranca dhe besëtytnitë e për t'i kthyer sytë nga shkenca dhe kultura. Zbulimet e mëdha shkencore dhe përmbajtja revolucionare e ideve iluministe u bënë mbështetje e fuqishme edhe për shndërrimet në fushat shoqërore. Karakteristika kryesore të lëvizjes ideo-artistike të kësaj periudhe në Evropë është shprehja e gjendjes shpirtërore zotëruese të epokës; e zhgënjimit dhe e pakënaqësisë ndaj realitetit ekzistues.

Format dhe mënyrat e shprehjes së kësaj pakënaqësie ishin të larmishme. Ato merrnin karakter dhe drejtime të ndryshme. Pikërisht për këto arsye dhe për të tjera, të cilat lidhen me gjithë lëvizjen shoqërore të kohës, kjo pjesë e shekullit do të mbyllet me periudhën e klasicizmit në muzikë, periudhë në të cilën arti muzikor fitoi tipare të reja, duke u ndarë nga stili i ngarkuar dhe plot fantazi i barokut.

Kulmin e saj madhështor periudha klasike e arriti me perfeksionimin e simfonisë në formë dhe përmbajtje, si dhe me lindjen e një koncepti të ri e të madh muzikor siç ishte forma e sonatës klasike.

- Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me **hapin III,** ku mësuesi/ja vendos disa foto me vepra arti të kësaj periudhe **(Reflektimi).** Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht:

1. Pse gjatë kësaj periudhe u arrit **perfeksionimi** i simfonisë?
2. Pse themi se në këtë periudhë lindi koncepti muzikor, siç ishte forma e sonatës klasike?

Ata japin mendimet e veta si dhe duke ballafaqohen me njohuritë që morën.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura të nxënësve në:

- - lidhjen e njohurive që ka me ngjarjet historike, artistike, politike, që lidhen me periudhën e Klasicizmi;
- - shpjegimin e risive të periudhës dhe zhvillimeve të mëtejshme që ndodhën në muzikë (opera bufa, seria, gjinitë e reja që lindën);

- krahasimin e një vepre muzikore të së njëjtës lloj të kësaj periudhe me një vepër muzikore të periudhës Baroke, duke renditur disa karakteristika; - prezantimin e linjës së kohës në të cilën u zhvillua muzika, gjinitë e ndryshme, instrumentet dhe përfaqësuesit. - respektimin e mendimit të mendimit të shokëve.
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit të kryejnë një: **Kërkim:** Gjeni materiale nga burime informacioni të ndryshme (foto, piktura, dokumente historike) për të zgjeruar më tej njohuritë rreth karakteristikave të kësaj periudhe, duke u ndalur te momentet që bënë jehonë. **Kërkim:** Gjeni materiale nga burime informacioni të ndryshme për të zgjeruar më tej njohuritë biografike dhe muzikore rreth përfaqësuesve të muzikës klasike dhe veprave që ata kompozuan. Krijoni album në Cd me muzikën e kësaj periudhe. **Ese:** Duke dëgjuar një veprat muzikore të L.V. Bethovenit apo V. A. Moxart, përshkruani përshkruani përjetimin tuaj emocional rreth muzikës së dëgjuar.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me mësimin e ri.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** Zhvillimi historik i zhanreve dhe stileve muzikore		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësit dallojnë dhe njohin karakteristikat e zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, jaz, rok) përmes dëgjimit muzikor. Nxënësit dallojnë karakteristikat stilistike dhe fitojnë njohuri për artin muzikor në epoka të ndryshme, njohin veprat dhe përfaqësuesit më të rëndësishëm të atyre epokave.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. V.2. Dëshmi e vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.1. Identifikojnë dhe elaborojnë me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror. 3.2. Përcaktojnë ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë. 3.3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit. 3.4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Muzika moderne			

- **Fjalët kyçe:** moderne, xhaz, rok, bluz.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- - shpjegon rëndësinë që ka muzika moderne në jetën shoqërore;
- - krahason zëra vokalë d.m.th. këngëtarë, instrumentistë të rrymave të ndryshme moderne;
- - krijon një Cd me këngët dhe këngëtarët e muzikës moderne të parapëlqyer;

- performon këngën e parapëlqyer.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, magnetofon, materiale nga interneti

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkenca dhe mjedisi, histori, gjeografi

Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme mbi muzikën moderne, grupet dhe këngëtarët.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos në Cd disa nga pjesët muzikore vokale ose instrumentale të luajtura apo të kënduara nga njerëz të mëdhenj të kësaj muzike.

Nxënësit gjejnë kush janë dhe diskutojnë rreth muzikës që ata luajnë apo këndojnë. Ata ndërthurin njohuritë që kanë me kohën kur u zhvilluan këto stile muzikore, ngrenë çështje, argumentojnë, shpjegojnë apo reflektojnë për ngjarje, instrumente apo fakte reale.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Hapi I

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me teknikën "**Kllaster"** ku mësuesi/ja shpjegon lindjen e muzikës bluz, xhaz, rok etj. Si lindën këto lloj muzikash dhe pse u pëlqyen dhe u mirëpritën nga masat.



Rhythm & Bluz
Muzika R&B (*Rhythm and blues*) është një lloj muzike shumë popullore, që gërsheton xhazin me muzikën bluz dhe u luajt për herë të parë nga artistët amerikanë me ngjyrë. Në vitin 1947 kjo lloj muzike kishte hyrë tashmë në tregun muzikor, ndërsa emri me të cilin njihet dhe sot, iu vendos në vitin 1949. Deri në fund të viteve 1950, ajo qe bërë e famshme dhe shumë kompani regjistrimi disqesh kishin prodhuar mijëra albume me këtë lloj muzike.
Muzika Rok
Muzika rok është një lloj muzike e përcaktuar gjerësisht, që u zhvillua në vitet 1960, me rrënjët e veta nga muzika *rock 'n' roll* dhe *rockabilly*, të cilat në vetvete rrjedhin nga muzika *rhythm and blues*, *country* dhe ndikime të tjera. Në shtesë të kësaj, muzika rok është influencuar edhe nga lloje të tjera muzike si muzika folk, xhaz dhe ajo klasike.
Muzika Hip-Hop\Rep
Hip Hopi është një kulturë që ka prejardhjen nga Nju Jork-u. DJ Afrika Bambataa ka hedhur hapat e parë të kulturës së hip-hopi-it me MC, DJ, duke bërë "beatbox". Së pari, hip hop-i ka filluar të krijohet nga DJ-t të cilët kanë krijuar tingujt ritmik në dy pllaka. DJ Kool Herc është ai që ka pasur mjaft rëndësi në zhvillimin e hiphopit. Në hiphop hyjnë: Dj-t, reperët, grafitët etj. Duhet ditur që të bëhet dallimi mes hiphopit dhe repit. Repi është pjesë përbërëse e hiphopit, pra ai që bën muzikë rep themi se është përfshirë në hiphop.

Nxënësit mund të sjellin konkretisht nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në internet, këngë apo muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë.

- Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me (**hapin III),** ku mësuesi/ja vendos disa foto me grupe muzikore dhe këngëtarë të kësaj periudhe **(Reflektimi).** Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.

Ata përgjigjen duke dhënë mendimet e veta si dhe duke ballafaquar me njohuritë që morën.
Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura të nxënësve në:
- - shpjegimin e rëndësisë që ka muzika moderne në jetën shoqërore;
- - krahasimin e zërave vokalë d.m.th. këngëtarë, instrumentistë të rrymave të ndryshme moderne;
- - krijimin e një Cd me këngët dhe këngëtarët e muzikës moderne të parapëlqyer;
- performimin e këngës së parapëlqyer.
- respektimin e mendimit të mendimit të shokëve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Nxënësit të kryejnë një:
Krijim: Cd me këngë të ndryshme të këtyre rrymave dhe materiale shoqëruese biografike.
Ese: Mbresat rreth këngëve të parapëlqyera. Punë individuale.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** Zhvillimi historik i zhanreve dhe stileve muzikore		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësit dallojnë dhe njohin karakteristikat e zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, jaz, rok) përmes dëgjimit muzikor. Nxënësit dallojnë karakteristikat stilistike dhe fitojnë njohuri për artin muzikor në epoka të ndryshme, njohin veprat dhe përfaqësuesit më të rëndësishëm të atyre epokave.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. V.2. Dëshmi e vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.1. Identifikojnë dhe elaborojnë me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror. 3.2. Përcaktojnë ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë. 3.3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit. 3. 4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Muzika e lehtë			
- **Fjalët kyçe:** muzikë e lehtë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - shpjegon rëndësinë që ka muzika e lehtë në jetën shoqërore; - krahason zëra vokalë d.m.th. këngëtarë të muzikës së lehtë duke veçuar karakteristikat e tyre; - krijon një Cd me këngët dhe këngëtarët e muzikës së lehtë shqiptare të parapëlqyer; - performon këngën e parapëlqyer; - respekton mendimin e shokëve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, magnetofon, materiale nga interneti			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkenca dhe mjedisi – historia & gjeografia Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme mbi muzikën e lehtë			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve **Hapi I** Mësimi fillon me një veprimtari konkrete Stili dëgjimor, ku mësuesi/ja vendos në një Cd disa këngë të kënduara nga këngëtarë të muzikës së lehtë ndër kohëra.			

Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth këngëve që dëgjojnë duke folur për:
- zërat dhe karakteristikat;
- interpretimin e këngës;
- melodinë dhe tekstin e këngës;
- tematikën që trajton;
- etj.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)
- **Hapi II**
- Veprimtaria mësimore vazhdon më tej ku jepen disa njohuri rreth zhvillimit të muzikës së lehtë në Shqipëri dhe Kosovë, përfaqësuesit dhe problemet që janë hasur në krijimin e saj.
- Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht rreth asaj që dinë rreth këngëve muzikës së lehtë.
- - Çfarë përfaqësonin ato për kohën? Nga kush këndoheshin?

Nxënësit mund të sjellin konkretisht nëpërmjet njohurive apo hulumtimeve që kanë bërë në internet, këngë apo muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë.
- Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që kanë, dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.
- Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me (**hapin III),** ku mësuesi/ja vendos disa foto nga këngëtarë dhe kompozitorë të muzikës së lehtë **(Reflektimi)**. Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht se pse i pëlqejnë këngët e muzikës së lehtë.

Ata japin mendimet e veta si dhe i ballafaqojnë me njohuritë që morën.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura të nxënësve në:
- - shpjegimin e rëndësisë që ka muzika e lehtë në jetën shoqërore;
- - krahasimin e zërave vokalë d.m.th. këngëtarëve shqiptarë, të muzikës së lehtë duke veçuar karakteristikat e tyre;
- - krijimin e një Cd me këngët dhe këngëtarët e muzikës së lehtë shqiptare të parapëlqyer;

- performimin e këngës së parapëlqyer;
- respektimin e mendimit të mendimit të shokëve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të kryejnë një:

Krijim: Cd me këngë të ndryshme të muzikës së lehtë shqiptare dhe materiale shoqëruese biografike.

Ese: Mbresat rreth këngëve të parapëlqyera. Punë individuale.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me mësimin e ri.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** Krijues dhe performues		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon nëpërmjet dëgjimit apo shfaqjes koncertale dallojnë muzikën skenike, koret dhe orkestrën. Njohin vepra artistike dhe krijues artistë të shquar dhe krijimtari popullore dhe artistike kombëtare dhe botërore të periudhave të ndryshme.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka.
V.2. Dëshmi e vetëbesimit.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Krijues dhe performues botërorë

Fjalët kyçe: interpretim, performim, përkryerje artistike

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- identifikon përfaqësues dhe interpretues të muzikës botërore përmes dëgjimit;
- shpjegon veprat dhe instrumentet muzikore që interpretuesit luajnë në shfaqje të ndryshme muzikore;
- shfaq parapëlqimin e vet për instrumentin që i pëlqen më shumë, duke dëgjuar dhe argumentuar shembuj të ndryshëm muzikore të ndryshëm;
- sjell informacione për krijuesit dhe interpretuesit më të njohur të muzikës botërore;
- respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet
Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko dhe kulturore.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete **(brainstorming)**, përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore, gjatë 20-30 sekondave nga interpretues dhe kompozitorë të ndryshëm botërorë. Vendosen CD me fragmente muzikore që luhen me instrumente, të cilat nxënësit i identifikojnë. Ata flasin rreth njohurive që kanë për këto lloj instrumentesh.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, me **teknikën "Harta e të pyeturit**" ku mësuesi/ja paraqet lloje të ndryshme instrumentesh muzikore, nëpërmjet një posteri ose një projektori dhe u kërkon nxënësve t'i identifikojnë ato sipas njohurive që kanë të marra ose të përjetuara.
Vazhdohet me vendosjen e disa fotove nga kompozitorë të ndryshëm të mëdhenj të muzikës botërore dhe interpretues botërorë.
Nxiten nxënësit të flasin rreth tyre me informacionin që kanë dhe njohuritë që marrin nëpërmjet librit të tyre të muzikës.

Nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në internet, nxënësit sjellin kuriozitete rreth krijuesve, interpretuesve dhe përfaqësuesve që kanë shkruar për këto instrumente, që kanë luajtur në këto instrumente dhe kanë zhvilluar më tej këto instrumente muzikore duke i diskutuar punët e tyre me shokët.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet muzikore nëpërmjet teknikës **Diagrami i Venit** ku vendosen dy kompozitorë të shquar austriakë: BAHU dhe MOXART dhe ajo që i bashkon ata është kombësia austriake.
Përgjigjet mund të jenë të ndryshme:
Luajnë në piano.
Kanë shkruar krijime metodike për instrumentin e pianos dhe jo vetëm etj.

Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura të nxënësve në:
- dëgjimin e fragmenteve muzikore nga përfaqësues të muzikës botërore;
- shpjegimin e veprave që dëgjon duke thënë disa karakteristika të veprës muzikore që dëgjon;
- grumbullimin dhe prurjen në klasë me CD/DVD të pjesëve instrumentale, sipas klasifikimit të veprave nga përfaqësues të parapëlqyer;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë interpretime nga repertori i kompozitorëve të ndryshëm botërorë përdorimin e mediave (DVD, CD, magnetofon), grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me mësimin e ri.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Çmuarja dhe vlerësimi estetik dhe artistik **Tema:** Vepra dhe ngjarje muzikore		**Rezultati i të nxënit të temës:** Komenton ngjarje të ndryshme artistike kombëtare, dhe botërore. Marrin pjesë në aktivitet të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës dhe vlerësojnë ato. Përjeton dhe vlerëson muzikën e epokave të ndryshme duke zhvilluar aftësitë e përjetimit estetik dhe vlerësimit kritik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. V.2. Dëshmi e vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 4.1. Demonstrojnë të kuptuarit se si artet komunikojnë ide përmes vlerave personale dhe shoqërore të frymëzuara nga imagjinata individuale dhe konteksti historik, kulturor dhe social i krijuesit. 4.2. Zhvillojnë mendimin e tyre kritik dhe analitik për të vlerësuar veprat e ndryshme të artit në aspektin estetik. 4.3. Zhvillojnë aftësinë e shijimit dhe përjetimit të veprave artistike duke kultivuar dhe rafinuar shijen e tyre estetike në art.
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Muzika në jetën e përditshme, muzika dhe lufta
- **Fjalët kyçe:** brirët, tamburet, trumbetat, këngë partizane, *big band*.
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - - përshkruan rolin dhe rëndësinë që ka muzika për të komunikuar në periudha të ndryshme; - - kupton rolin e disa instrumenteve muzikore gjatë luftërave në periudha të ndryshme historike; - - shpjegon rolin e instrumenteve në luftë; - ndërton dhe argumenton me raste reale se si ndikon muzika në moment të vështira të jetës njerëzore; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, mjete të tjera për të punuar
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko dhe kulturore.
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos disa foto apo fragmente (Dvd) nga filmi "Pianisti", i regjisorit Roman Polanski.
Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth fotove apo pamjeve që shikojnë nga filmi, i cili pasqyron marrëdhënien dhe rolin e muzikës në kohë lufte. Ata ngrenë çështje, argumentojnë, shpjegojnë apo reflektojnë për ngjarje, instrumente apo fakte reale analoge me atë të filmit "Pianisti".
Vendosen foto apo fragmente (Dvd) "Gëzuar krishtlindjet" i regjisorit Kristian Karion (Christian Carion).

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)
Hapi II
Ndërkohë shpjegohet **si** dhe **pse** muzika ka shoqëruar luftërat që në kohët e lashta. Gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, muzika kishte një funksion shumë të rëndësishëm. Në Itali lindën këngë popullore që tregonin për vuajtje dhe padrejtësi ose që rikujtonin me nostalgji jetën larg frontit të luftës. Shumë vende që ishin në luftë dërgonin artistët e tyre në kampet ushtarake, për të ngritur dhe mbajtur lart moralin e ushtarëve.
Xhazi në luftë është një lloj muzike u luajt shpesh në zonat që ishin fronte lufte gjatë Luftës së Dytë Botërore, për të larguar vëmendjen e ushtarëve nga betejat.
Edhe në Shqipëri gjatë dy luftërave botërore u krijuan këngë patriotike dhe më pas këngët partizane që pasqyronin idealet e kohës në të cilën u krijuan. Këto ishin kërkesat dhe idealet që kishin popujt e Evropës, gjatë kësaj periudhe.

- **Hapi III**
- Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja vendos në Cd këngë të ndryshme partizane. Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht rreth asaj që dinë për këngët partizane.

Çfarë përfaqësonin ato për kohën? Nga kush këndoheshin?

Hapi IV
Reflektim nxënësit drejtohen të gjejnë ndryshimet ose të përbashkëtat e muzikës që dëgjojnë si dhe diskutojnë me njëri-tjetrin duke ballafaquar njohuritë që kanë dhe për qëllimin që u krijuan këto këngë.
Nxënësit mund të sjellin konkretisht, nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në internet, këngë apo muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që kanë.
Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse i pëlqejnë.

Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura të nxënësve në:
- - përshkrimin e rolit dhe rëndësisë që ka muzika për të komunikuar në periudha të ndryshme;
- - shpjegimin e rolit e disa instrumenteve muzikore gjatë luftërave në periudha të ndryshme historike;
- - shpjegimin e rolin e instrumenteve në luftë;
- ndërtimin dhe argumentimin me raste reale se si ndikon muzika në moment të vështira të jetës njerëzore;
  - krijimin e mendimit krijues personal, i nxitur nga përqendrimi dhe zhvillimi i të menduarit gjatë veprimtarisë mësimore;
  - për respektimin e mendimit të mendimit të shokëve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit dëgjojnë këngën disa herë dhe të krijojnë një **ese/krijim individual**:
Detyrë përmbledhëse: Materiale dhe të dhëna mbi veprën muzikore Oratorio për kor dhe orkestër "Një i mbijetuar i Varshavës" të kompozitorit Arnold Shënberg (*Arnold Schönberg*). Punë në grupe.
Ese: Mbresat rreth kësaj veprës muzikore oratorio për kor dhe orkestër "Një i mbijetuar i Varshavës" të kompozitorit Arnold Shënberg.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me mësimin e ri.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Çmuarja dhe vlerësimi estetik dhe artistik **Tema:** Vepra dhe ngjarje muzikore		**Rezultati i të nxënit të temës:** Komenton ngjarje të ndryshme artistike kombëtare, dhe botërore. Marrin pjesë në aktivitet të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës dhe vlerësojnë ato. Përjeton dhe vlerëson muzikën e epokave të ndryshme duke zhvilluar aftësitë e përjetimit estetik dhe vlerësimit kritik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. V.2. Dëshmi e vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 4.1. Demonstrojnë të kuptuarit se si artet komunikojnë ide përmes vlerave personale dhe shoqërore të frymëzuara nga imagjinata individuale dhe konteksti historik, kulturor dhe social i krijuesit. 4.2. Zhvillojnë mendimin e tyre kritik dhe analitik për të vlerësuar veprat e ndryshme të artit në aspektin estetik. 4.3. Zhvillojnë aftësinë e shijimit dhe përjetimit të veprave artistike duke kultivuar dhe rafinuar shijen e tyre estetike në art. 4. 4.Krijojnë kulturën debatuese për diskutimin dhe trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Muzika në jetën e përditshme, Muzika dhe sporti			
- **Fjalët kyçe:** sporti, tromba, daullja, ritme muzikore, not i sinkronizuar, balet në akull.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - - përshkruan rolin dhe rëndësinë që ka muzika në zhvillimin e sporteve të ndryshme; - - shpjegon rolin e muzikës në ekzekutimin e sporteve të ndryshme artistike; - - përgatit material me rolin dhe funksionin e muzikës sporte të ndryshme; - - përgatit Dvd ose Cd me muzikë për sporte të ndryshme: fitnes, patinazh etj.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko dhe kulturore.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos disa foto nga sporte të ndryshme ku nxiten nxënësit të diskutojnë rreth sporteve dhe rreth muzikës që i shoqëron këto lloje sportesh.

Pse muzika është një element i rëndësishëm në zhvillimin e këtyre sporteve?

Cila muzikë i shoqëron kryesisht këto lloje sportesh?

Më pas vendoset fragment nga kënga (Cd) "Ti nuk do të ecësh kurrë vetëm" (*You will never walk alone*) këngë e cila këndohet nga tifozët anglezë. Diskutohet rreth saj.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Hapi II

Ndërkohë shpjegohet **pse** në një veprimtari sportive përzgjedhja e duhur muzikore ndikon në përjetimin dhe praktikimin më të mirë të disiplinës sportive.

Sporti sot praktikohet nga një numër shumë i madh njerëzish dhe është forma më popullore e argëtimit dhe jo vetëm, nëpër botë. Muzika në të ka funksione të ndryshme. Atë e gjejmë në këngët dhe tingujt e krijuar nga tifozët e skuadrave të futbollit. Këndimi i tyre i jep kurajë dhe i shton pozitivitetin skuadrës së zemrës dhe shkakton të kundërtën për skuadrën tjetër.

Në manifestimet e mëdha e të përbashkëta, si në Lojërat Olimpike ose në kampionatet botërore, muzika kërkon të japë idenë e solidarizimit të sporteve dhe të njerëzve.

-

- **Hapi III**
- Veprimtaria mësimore vazhdon më tej ku mësuesi/ja vendos në Dvd momente filmike me pamje dhe muzikë që paraqesin patinazh artistik apo not të sinkronizuar. Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht rreth tyre:
- - çfarë dinë rreth notit të sinkronizuar;
- - çfarë dinë për patinazhin artistik.
- **Hapi IV**

Nxënësit mund të sjellin konkretisht nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në internet, muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë.

- Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.
- Nxënësit mund të sjellin konkretisht nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në internet, muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë.

Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura të nxënësve në:

- përshkrimin e rolit dhe rëndësisë që ka muzika në zhvillimin e sporteve të ndryshme;
- - shpjegimin e rolit të muzikës në ekzekutimin e sporteve të ndryshme artistike;
- - përgatitjen e Dvd ose Cd me muzikë për sporte të ndryshme: fitnes, patinazh etj.;
- krijimin e mendimit krijues personal, i nxitur nga përqendrimi dhe zhvillimi i të menduarit gjatë dëgjimit muzikor.

Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë dhe të krijojnë një punim të vetin: **Kërkim** (Punë individuale): Organizoni një ecje sportive së bashku. Diskutoni me njëri-tjetrin dhe vendosni së bashku për muzikën që do të zgjidhni për të dëgjuar në kufje. Mbani parasysh që muzika e zgjedhur duhet t'ju ndihmojë për të mbajtur një ritëm të qëndrueshëm dhe energjik. Mos harroni që gjatë diskutimit të respektoni sugjerimet e secilit, në mënyrë që në fund të gjithë të jenë të kënaqur nga zgjedhja muzikore dhe në vijim nga e gjithë veprimtaria. Diskutoni së bashku pastaj në klasë për çka përjetuat, mbi çka dinit dhe çka mësuat.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me mësimin e ri.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Art muzikor	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X (dhjetë)
Konceptet: Çmuarja dhe vlerësimi estetik dhe artistik **Tema:** Vepra dhe ngjarje muzikore		**Rezultati i të nxënit të temës:** Komenton ngjarje të ndryshme artistike kombëtare, dhe botërore. Marrin pjesë në aktivitet të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës dhe vlerësojnë ato. Përjeton dhe vlerëson muzikën e epokave të ndryshme duke zhvilluar aftësitë e përjetimit estetik dhe vlerësimit kritik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja e mirë gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. V.2. Dëshmi e vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 4.1. Demonstrojnë të kuptuarit se si artet komunikojnë ide përmes vlerave personale dhe shoqërore të frymëzuara nga imagjinata individuale dhe konteksti historik, kulturor dhe social i krijuesit. 4.2. Zhvillojnë mendimin e tyre kritik dhe analitik për të vlerësuar veprat e ndryshme të artit në aspektin estetik. 4.3. Zhvillojnë aftësinë e shijimit dhe përjetimit të veprave artistike duke kultivuar dhe rafinuar shijen e tyre estetike në art. 4.4. Krijojnë kulturën debatuese për diskutimin dhe trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Muzika e filmi dhe e reklamave			
- **Fjalët kyçe:** filmi dhe muzika, filmi dhe reklama, kolonë zanore.			

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- - përshkruan rolin dhe rëndësinë që ka muzika në një film artistik/dokumentar/kartonë;
- - veçon dhe shpjegon muzikën preferuar të një filmi artistik apo reklame;
- - shpjegon rëndësinë që ka elementi muzikë (kolona zanore) në marrjen e një çmimi Oskar.
- - mban qëndrim dhe krahason muzikë të filmave apo reklamave të ndryshëm duke bërë rolin e jurisë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 10, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet
Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko dhe kulturore.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve
Hapi I
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete, ku mësuesi/ja vendos fragment nga kolona zanore (Cd). Vendoset në Cd/Dvd kolona muzikore e filmit të Enio Morrikone-s. Nxiten nxënësit të flasin rreth kësaj muzike:
- Sa rëndësi ka muzika në vlerësimin e një filmi artistik?
- Cila është kolona zanore juaj e preferuar?
- A përcjell muzika idenë që transmeton edhe filmi?
- A është Kuentin Tarantino një tjetër regjisor i kujdesshëm ndaj muzikës apo kolonës zanore të filmave të tij?

Hapi II
Foto apo fragmente (Dvd) "Dritat e qytetit" ku luan aktori Çarli Çaplin.
Hapi III
Ndërkohë shpjegohet mbi muzikën e filmit i cili përfshin stile e forma muzikore të ndryshme: klasike, pop, xhaz, rok, muzikë tradicionale nga vende të ndryshme etj. Interpretimi i saj vjen me forma të ndryshme, si: me orkestër, këngë të thjeshta, ansamble të vogla instrumentale, muzikë elektronike etj. Me futjen e teknologjisë digjitale, format e muzikës janë pasuruar akoma edhe më shumë. Mjaft të njohura në muzikën e filmit janë lajtmotivet (melodi ose tema muzikore të shkurtra që përsëriten shpesh gjatë filmit dhe që ngelen në vesh) dhe këngët, që krijohen për të shoqëruar një film.

Ndërtimi i njohurive të reja
Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me **hapin IV**, ku mësuesi/ja vendos disa foto nga filmi **"Kumbari"** i regjisorit Francis Ford Coppola (Ky film doli për herë të parë në vitin 1972 dhe shënoi historinë e kinemasë botërore), apo nga filmi "Lulëkuqet mbi mur" duke kujtuar edhe kolonën zanore të këtyre filmave.
Hapi V
Më tej vazhdohet me shpjegimin e reklamës që transmetohet nga të gjitha mjetet e komunikimit audio-vizive: radioja, televizioni, kinemaja dhe interneti. Muzika është një prej elementeve të saj. Fjalët e përdorura dhe emocioni që ajo krijon, luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e produktit të paraqitur në reklamë. Muzika shoqëruese i përshtatet fjalëve dhe mund të jetë e lehtë, festive, solemne, trishtuese ose melankolike, në varësi të qëllimit të reklamës. Sot, reklamimi është kthyer në një industri të fuqishme.

Nxënësit mund të sjellin konkretisht, nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në internet, muzikë në funksion të njësisë mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë.
Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura të nxënësve në: - - shpjegimin e rolit që ka muzika në një film artistik/dokumentar/të animuar; - - shpjegimit të muzikës së preferuar të një filmi artistik apo reklame; - - shpjegimin e elementeve që përbëhet kolona zanore në një film; - - qëndrimin ndaj muzikës që përfaqëson një film apo reklamë duke bërë rolin e jurisë; - - për respektimin e mendimit të mendimit të shokëve.
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë dhe të krijojnë një punim të vetin. Krijoni në DVD reklamën e një produkti duke përfshirë të gjitha elementet e saj.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me mësimin e ri.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37.016:78(072)(075.3)

Hala, Majlinda

Libër për mësuesin : art muzikor 10 : për klasën e 10-të të arsimit të mesëm të përgjithshëm / Majlinda Hala, Valbona Duraj - Muho. - Prishtinë : Botime Pegi, 2019. - 75 f. : me il. ; 20.7 x 28 cm.

1. Duraj - Muho, Valbona

ISBN 978-9951-786-09-6
Lejohet për botim me vendimin e Ministrisë
së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë,
nr. 319/01-B, të datës 16.07.2019.